



Mogherini ka tradhtuar parimet evropiane

Taksa vret idenë djallëzore
të ndryshimit të kufijve

Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, beson se tani nuk është koha e duhur për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se për marrëveshjen përfundimtare ndërmjet

dy shteteve duhet pritur udhëheqjen e re të Bashkimit Evropian (BE). Sipas saj, shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, ka tradhtuar parimet evropiane. Ish-ministrja Tahiri ka thënë se taksa 100 për qind ndaj pro-

dukteve të Serbisë tani është mekanizmi i vetëm që vret idenë e ndryshimit të kufijve. Ajo u ka bërë thirrje partive politike që të bëhen bashkë për mbrojtje të interesit kombëtar të shtetit të Kosovës, në këtë rast të mbrojtjes së kufijve

OSBE-ja KËRKON NGA KOSOVA TA LUFTOJË KORRUPSIONIN

Institucionet e Kosovës duhet të kenë qasje serioze dhe sistematike në luftën kundër korrupsionit. Kështu ka deklaruar shefi i misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) në Kosovë, Jan Brathu, në konferencën me temë "Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit të nivelit të lartë". Ai ka thënë se korrupsioni i nivelit të lartë duhet të ndëshkohet pasi e dëmton shtetësinë, ekonominë dhe zhvillimin



e Kosovës. Ndërsa presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Kosova ka ndërmarrë një sërë masash për ta luftuar korrupsionin IFAQE 3



Qalaj: Siguria në trafikun rrugor vazhdon të mbetet sfidë

IFAQE 6

AKTUALE

**FILLOJNË PËRGATITJET PËR
REGJISTRIMIN E DYTË TË
POPULLSISË NË KOSOVË** F. 7

**RAHIM HASHIMI, I FTUARI
I RADHËS NGA GJYKATA
SPECIALE** F. 7

**PSD-ja DHE NISMA KËRKOJNË
HISE NË KOZ** F. 6

EKONOMI

**VESELI KËRKON
BASHKËPUNIM MË TË MADH
MIDIS INSTITUCIONEVE DHE
ODAVE EKONOMIKE** F. 9

**HARADINAJ KËRKON
SEANCË MË 3 PRILL PËR
PROJEKTLIGJIN QË NDALON
LOJËRAT E FATIT** F. 9

KULTURË

**NË DITËN BOTËRORE TË
TEATRIT, MINISTRI GASHI
DHA ÇMIMET PËR TEATËR** F. 11

SPORT

**PRISHTINA RIKTHEHET NË
VENDIN E DYTË** F. 16

**KARATEISTËT SYNOJNË
MEDALJE NË GUADALAJARA
TË SPANJËS** F. 13



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Clark: 20 vjet më parë ndalëm spastrimin etnik në Kosovë

PRISHTINË, 27 MARS - Ish-komandanti i lartë i NATO-s, Wesley Clark, njeriu që drejtoi fushatën e bombardimeve të NATO-s kundër forcave serbe në vitin 1999 tha, në një intervistë për "Zërin e Amerikës", se falë atyre u ndalua spastrimi etnik në Kosovë dhe se aleanca nuk kishte zgjidhje tjetër. Clark sqaroi se përpjekje për ta shmangur luftën ishin bërë që në fillim të viteve '90, kur Perëndimi u ndërgjegjësua mbi gjendjen e rëndë që ishte krijuar. Shefi i atëherëshëm i Shtëpisë së Bardhë, George H. Bush, i kishte dërguar kreut serb

Slobodan Millosheviq një paralajmërim, se do të përballej me pasoja të rënda nga ShBA-ja nëse fillonte spastrimin etnik të shqiptarëve. Por, Millosheviqi, nga sa pohon ish-zyrtari i lartë, refuzonte të diskutonte për Kosovën, duke e cilësuar atë si "çështje të brendshme". "Ne përdorëm forcën vetëm si zgjidhjen e fundit fare. NATO-ja nuk mund të lejonte një raund të ri të spastrimit etnik nga serbët. Sapo kishim ndaluar një gjë të tillë në Bosnjë dhe nuk mund të lejonim një përsëritje të saj në Kosovë, ndaj u përgjigëm me forcë, edhe pasi rusët

refuzuan të ndihmojnë", tha Clark. Pikëpamja e Moskës ishte se kjo ishte "çështje e brendshme serbe" dhe nëse ata donin të vrisnin një milion njerëz, "kjo ishte e drejta e tyre". "Por kjo, shtoi ai, nuk ishte pikëpamja jonë". Gjenerali i hodhi poshtë pohimet ruse, sipas të cilëve, ka pasur shumë të vrarë nga bombat e NATO-s, se ndërhyrja e saj ishte e paligjshme dhe e padrejtë. Ai theksoi se, përpara se të goditej ndërtesa e Radiotelevizionit të Serbisë, Millosheviqi ishte paralajmëruar në mënyrë që të shmangeshin viktimat.



Kanadaja i jep mbështetje zhvillimit të FSK-së

Kryesuesi i Asociacionit Parlamentar të NATO-s në Kanada, Borys Wrzesnewskyj, ka takuar të mërkurën në Prishtinë përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës. Gjatë takimit me presidentin Hashim Thaçi dhe ministrin e Mbrojtjes, Rustem Berisha, ka konfirmuar përkrahjen e Kanadasë për zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)



Kanadaja ka dhënë për Kosovën, e ka njoftuar edhe me zhvillimet e fundit, me miratimin e ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. "Kuvendi i Kosovës në mënyrë unanime ka miratuar tri ligjet për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Përkrahja e marrë prej 107 deputetëve nga 120 sa ka Kuvendi, na ka bërë që të punojmë edhe më shumë për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi tona". "Mandati i ri i FSK-së do ta ruajë karakterin profesional, me mision mbrojtës. Një forcë e hapur për të gjithë qytetarët dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ne jemi zotuar se rajoni do të ketë edhe një forcë aleate, të ndërveprueshme me aleatët dhe në shërbim të krijimit dhe ruajtjes së paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në rajon dhe më gjerë, jo vetëm konsumues, por edhe ofrues të paqes. Përkrahja e Kanadasë edhe në këtë proces është shumë domethënëse për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në", ka thënë Berisha. Ndërsa deputeti Borys Wrzesnewskyj ka falënderuar ministrin Berisha për informimin e detajuar lidhur me zhvillimet në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në. Ai edhe një herë ka shprehur përkrahjen e Kanadasë për proceset në të cilat po kalojnë Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 MARS - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka takuar të mërkurën deputetin e Parlamentit të Kanadasë, Borys Wrzesnewskyj, njëherësh kryesuesi i Asociacionit Parlamentar të NATO-s në Kanada, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin e Kosovës dhe Kanadasë, veçanërisht në sektorin e sigurisë. Thaçi është shprehur i kënaqur që Kosova dhe Kanadaja këtë vit shënojnë 10-vjetorin e marrëdhënieve diplomatike në mes dy vendeve, derisa e ka falënderuar deputetin Wrzesnewskyj për përkrahjen e vazhdueshme që Kanadaja i ka dhënë Kosovës. "Jemi mirënjohës për mbështetjen që na keni dhënë në të gjitha fazat. Tani po punojmë për forcimin e paqes dhe për stabilitetin e qëndrueshëm. Është njësoj e rëndësishme të përkrahët Kosova edhe tani, veçanërisht në përpjekjet për ta arritur marrëveshjen e përhershme paqësore me Serbinë dhe në transformimin e FSK-së në forcë

të gatshme për t'u bërë anëtare e NATO-s", ka thënë Thaçi. Presidenti Thaçi ka thënë se Kosova është e qartë se të ardhmen e sheh në NATO dhe BE. Ndërsa deputeti Wrzesnewskyj ka thënë se e njeh mirë rrugën e vështirë dhe tragjike të Kosovës dhe se e kupton rëndësinë e sigurisë së përgjithshme. "Është inkurajues zhvillimi i deritashëm i Kosovës në përgjithësi dhe zhvillimi i FSK-së në veçanti", ka thënë ai.

Veseli: Kosova dhe Kanadaja do ta vazhdojnë thellimin e bashkëpunimit

Edhe kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të mërkurën në takim kryesuesin e Asociacionit Parlamentar të NATO-s në Kanada, deputet federal, njëherësh zëvendëskryetar i Grupit Parlamentar të Miqësisë Kanada-Kosovë në Parlamentin kanadez, Borys Wrzesnewskyj.

Në këtë takim kryeparlamentari Veseli dhe deputeti Wrzesnewskyj kanë biseduar për raportet shumë të mira që Kosova dhe Kanadaja i kultivojnë ndërmjet tyre në shumë nivele të bashkëpunimit institucional, njëherësh kanë vlerësuar se kjo traditë e bashkëpunimit duhet vazhduar dhe thelluar më tej në të ardhmen. Kryetari i Kuvendit ka thënë se me shtete mike në krahë si Kanadaja, Kosova ndihet e sigurt për arritjen e aspiratave të saj për avancim të mëtejshëm të demokracisë, zhvillim ekonomik dhe ecje më të shpejtë në rrugën e integritimit euroatlantik. Ai ka falënderuar ligjvënësin kanadez për ndihmën dhe mbështetjen që

Kanadaja ka dhënë për Kosovën në të gjitha etapat.

Ministri Berisha merr përkrahje nga Kanadaja për Ministrinë e Mbrojtjes dhe ushtrinë

Ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, ka pritur në takim deputetin e Kanadasë, njëherësh kryesuesi i Asamblesë Parlamentare kanadeze të NATO-s, Borys Wrzesnewskyj, i cili ka qenë i shoqëruar edhe nga ambasadori i Kanadasë që mbulon edhe Kosovën, Daniel Maksymiuk. Ministri Berisha, pasi e ka falënderuar deputetin Wrzesnewskyj për ndihmën dhe përkrahjen e madhe që

Cakaj flet sërish për shkarkimet në diplomaci



Tiranë, 27 mars - Pasi ka folur për valën e pastrimit të diplomatëve dhe të mbi 20 punonjësve, ministri i Jashtëm në detyrë, Gent Cakaj, është shprehur se do të ketë dhe shkarkime të tjera në rast se performanca e punon-

jësve nuk do të jetë në nivelin e duhur. E pranishme në Komisionin e Integritimit, deputetja e PD-së, Rudina Hajdari, e ka pyetur Cakajn për këtë vendim të marrë prej tij. Cakaj është përgjigjur duke

thënë se disa prej të larguarve kanë tejkaluar sjelljen e diplomatit, ndërsa disa të tjerë nuk janë në lartësinë e duhur. "Të tjera shkarkime, nëse performanca nuk do të jetë në nivelin e duhur. Jam i gatshëm t'i thelloj reformat e

të marrveprime të guximshme që të rinj e të reja me rezultat e të shkëlqyera të bëhen pjesë e trupit diplomatik. Një pjesë e tyre nuk mund të qëndrojnë në misione diplomatike për shtatë vjet pa asnjë transferim", tha Cakaj.

Është mbajtur konferenca me temë "Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit të nivelit të lartë"

OSBE-ja kërkon nga Kosova ta luftojë korrupsionin

Institucionet e Kosovës duhet të kenë qasje serioze dhe sistematike në luftën kundër korrupsionit. Kështu ka deklaruar shefi i misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) në Kosovë, Jan Brathu, në konferencën me temë "Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit të nivelit të lartë". Ai ka thënë se korrupsioni i nivelit të lartë duhet të ndëshkohet pasi e dëmton shtetësinë, ekonominë dhe zhvillimin e Kosovës. Ndërsa presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Kosova ka ndërmarrë një sërë masash për ta luftuar korrupsionin



Kosovës ka marrë një sërë veprimesh me qëllim të konsolidimit të sundimit të ligjit dhe në funksion të respektimit të rendit kushtetues, si dhe ka miratuar legjislacionin përkatës për këtë fushë, duke krijuar mekanizma institucionalë dhe ndërinstucionalë për këtë qëllim. "Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë, e prirë për t'i luftuar dukuritë negative, në këtë rrafsh edhe korrupsionin e të gjitha niveleve, e ushqejnë rritjen ekonomike dhe rregullojnë mirëqenien e qytetarëve", ka deklaruar Thaçi. Presidenti ka theksuar se gjatë vitit 2018 dhe fillimit të vitit 2019 Republika e Kosovës ka bërë hapa të mëdhenj në konsolidimin e legjislacionit që ndërlihet me fushën kundër korrupsionit, duke nxjerrë ligje të reja apo ndryshuar dhe plotësuar ato aktuale. "Kodi Penal i Kosovës,

që pritet të hyjë në fuqi në prill të këtij viti, Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Ligji për Gjykatat, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike. Ky legjislacion mundëson që në mënyrë sa më efektive të sinjalizohen, parandalohen, hetohen dhe gjykohen veprat penale të natyrës korruptive", ka thënë Thaçi, duke shtuar se Kosova gradualisht ka rritur numrin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në pajtim me nevojat si dhe ka ngrehur kapacitetet e institucioneve

të tjera të zbatimit të ligjit. "Përkundër rezultateve, ne duhet edhe më tej ta vazhdojmë luftën e pakompromis ndaj korrupsionit, duhet t'i tejkalojmë ngecjet e identifikuar, duke vepruar dhe zbatuar ligjet me një rigorozitet dhe përkushtim edhe më të madh", ka theksuar presidenti Thaçi. Ai ka thënë se tash gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Kosovës kanë kushte të mira të punës dhe të ardhura të dinjitetshme. "Ju mbetet të punojnë me përkushtim dhe profesionalizëm, ta respektojnë betimin e dhënë kur e kanë marrë detyrën", ka deklaruar presidenti Thaçi. Ai u ka bërë thirrje zyrtarëve të institucioneve të zbatimit të ligjit, në veçanti gjyqtarëve dhe prokurorëve, që luftën ndaj korrupsionit ta kenë prioritet.

**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 MARS - Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) në Kosovë të mërkurën ka mbajtur konferencën me temë "Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit të nivelit të lartë", ku është kërkuar angazhim serioz për luftimin e korrupsionit. Shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadori Jan Brathu, ka thënë se Kosova ka bërë disa përparime në luftimin e korrupsionit por, sipas tij, në këtë drejtim duhet bërë edhe më shumë. Ai ka deklaruar se institucionet e Kosovës duhet të kenë qasje serioze dhe sistematike në luftën kundër korrupsionit. Sipas tij, institucionet nuk kanë bërë përpjekje të mjaftueshme për të ndjekur raste, prandaj ka pasur më pak procese gjyqësore të rasteve për abuzim me pozitën zyrtare. "Në vitin 2018 në gjykata kanë qenë 774 raste të ndërlidhura me korrupsionin. OSBE-ja ka monitoruar 328 raste gjyqësore që prej 2016-s deri tani. Sipas vëzhgimit tonë, bazuar në rastet ku janë përfshirë persona të akuzuar për abuzim të pozitës zyrtare, ka rënë numri nga 168

raste në vitin 2016, në 122 raste në vitin 2018. Por, kjo rënie, fatkeqësisht, nuk do të thotë se është arritur sukses në përpjekjet për ta luftuar korrupsionin, por mund të lë të kuptohet se ka pasur përpjekje të pamjaftueshme nga institucionet e rëndësishme për të ndjekur raste të tilla", ka deklaruar Brathu. Ai ka thënë se korrupsioni i nivelit të lartë shkatërron shtetin dhe minon besimin në institucionet e shtetit. "Korrupsioni i nivelit të lartë duhet të ndëshkohet, sepse dëmton shtetësinë, ekonominë dhe zhvillimin e Kosovës", është shprehur ambasadori Brathu. Ndërsa presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se korrupsioni është një kërcënim serioz jo vetëm për vendin tonë, por edhe për vendet më të zhvilluara dhe përbën një sfidë për demokracinë. Sipas tij, Kosova duhet të jetë e pakompromis në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie. "Fenomeni i korrupsionit është një sfidë në shkallë globale. Përveç pasojave që shkakton në zhvillimet politike dhe socio-ekonomike, dukuria e korrupsionit shkakton pasoja edhe në rrafshin e sigurisë", ka theksuar ai. Thaçi ka thënë se Republika e

Haradinaj: Hapja e çështjes së kufijve do ta destabilizojë gjithë rajonin

PRISHTINË, 27 MARS (ER) - Në një intervistë dhënë gazetarit Thomas Roser, e publikuar në gazetën "Die Presse", "Stuttgarter Zeitung" dhe "Tageblatt", kryeministri Ramush Haradinaj ka theksuar se Kosova nuk do të diskutojë për kufij dhe territore. Ai ka thënë se dialogu i udhëhequr nga BE-ja do të duhej të çonte te një marrëveshje me Serbinë, përfshirë njohjen e Kosovës, por se ky rezultat nuk u arrit. "Hapja e çështjes së kufijve nuk do ta

destabilizonte vetëm Kosovën, por të gjithë rajonin. Ne kemi përmbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave, por deri tani BE-ja nuk realizoi pjesën e saj. Vendi ynë përshëndet zgjidhjen e konfliktit për emrin midis Maqedonisë dhe Greqisë. Por, kjo energji mungon në lidhje me çështje të tjera të hapura në rajon", ka thënë Haradinaj për këto media, të cilin qëndrimin e ka paraqitur edhe në llogarinë e vet në "Facebook".



Flet për "Epokën e re", Edita Tahiri

Mogherini ka tradhtuar

- Taksa vret idenë djallëzore të ndryshimit të kufijve



Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, beson se tani nuk është koha e duhur për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se për marrëveshjen përfundimtare ndërmjet dy shteteve duhet pritur udhëheqjen e re të Bashkimit Evropian (BE). Sipas saj, shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, ka tradhtuar parimet evropiane. Ish-ministrja Tahiri ka thënë se taksa 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë tani është mekanizmi i vetëm që vret idenë e ndryshimit të kufijve. Ajo u ka bërë thirrje partive politike që të bëhen bashkë për mbrojtje të interesit kombëtar të shtetit të Kosovës, në këtë rast të mbrojtjes së kufijve

evropiane të integritit të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, ashtu siç është konfirmuar edhe me strategjinë e fundit për zgjerim të BE-së", ka thënë Tahiri.

Ai e ka ftuar Qeverinë e Kosovës që mos ta heqë taksën për mallrat serbe. Sipas saj, kjo taksë është mekanizmi i vetëm i cili po i mbron kufijtë e Republikës së Kosovës. "Taksa momentalisht është mekanizmi i vetëm që vret idenë e ndryshimit të kufijve. Me fjalë të tjera, i mbron kufijtë e shtetit të Kosovës sepse, siç e pamë të gjithë, Kuvendi i Kosovës dështoi që të krijojë një qëndrim të unifikuar të spektrit politik në një platformë. Pra, platforma u votua vetëm nga subjektet

politike që janë në pushtet dhe PSD-ja", është shprehur Tahiri. Së pari, sipas saj, liderët institucionalë duhet ta shohin interesin kombëtar dhe më pas raportet me ndërkombëtarët. "Gjithmonë duhet parë se a po lëkunden raportet me popullin tënd, sepse lojërat djallëzore për kufij kanë lëkundur raportet e disa liderëve me popullin shqiptar. Pastaj vijnë raportet me ndërkombëtarët. Edhe në vitet e çlirimit, kur ne kërkonim pavarësi, faktori ndërkombëtar nuk ishte me neve. Por, ne qëndruam, luftuam dhe faktori ndërkombëtar, duke përfshirë ShBA-në, doli në anën tonë. Pra, fillimisht duhet të shikohen raportet me popullin", është shprehur Tahiri.

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 27 MARS - Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka bërë me dije se tani nuk është koha për marrëveshjen përfundimtare Kosovë - Serbi. Ajo ka deklaruar se për të vazhduar

dialogu i Brukselit ndërmjet dy shteteve duhet pritur udhëheqësin e re të Bashkimit Evropian. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri e ka akuzuar shefen e politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini, se ka tradhtuar parimet evropiane.

"Qëndrimi ynë si Kosovë duhet të jetë që të mos kemi marrëveshje në këtë kohë. Pra, të presim të shkojë Mogherini, e cila ka tradhtuar parimet evropiane dhe të presim ndryshime në udhëheqjen e BE-së. Shpresojmë të vijë një udhëheqje që mbron parimet

parimet evropiane



politike që janë në pushtet dhe nga PSD-ja. Në këtë mënyrë taksa është ajo që po vonon këtë dialog. Mendim im është se ky dialog duhet të vonohet derisa të shkojë Mogherini me gjithë ekipin e saj, të cilët shkelën parimet evropiane, duke hapur mundësinë që të bisedohet për temën e kufijve, e cila është e rrezikshme jo vetëm për interesat kombëtare të Kosovës dhe të shqiptarëve, por edhe për stabilitetin në Ballkan. Prekja e kufijve nuk bëhet me paqe, por me luftë. Kjo do t'i kthente armiqësitë e vjetra dhe rrezikon që i gjithë Ballkani të përfshihet në këtë situatë.

"Epoka e re": A do të thotë kjo se për ta vazhduar dialogun e Brukselit, Kosova duhet ta presë udhëheqjen e re të BE-së pas zgjedhjeve që priten të mbahen në pranverë?

Tahiri: Nuk mund të flas në emër të qeverisë, por mund të flas si ish-kryenegociatore. Nga njohuritë e mia në marrëdhëniet ndërkombëtare mund të them se nuk është kjo koha e duhur për të bërë dialog, sepse kemi pasur lojëra djallëzore, sekrete, të treshes së njohur tashmë Thaçi-Vuçiq-Rama për këtë çështje. Por, siç dihet, këto lojëra mbeten pa përkrahje, sepse edhe një herë populli i Kosovës tregoi se askush nuk mund të punojë pas shpinës dhe as kundër vullnetit të tij. Këtë po e them si një ndër themelueset e këtij shteti të Kosovës që kam luftuar 30 vjet për këtë ëndërr.

"Epoka e re": Megjithatë, është konstatim i përgjithshëm se taksa ka lëkundur raportet e Kosovës me Perëndimin?

Tahiri: Së pari, gjithmonë duhet parë se a po lëkunden raportet me popullin tënd, sepse lojërat djallëzore për kufij kanë lëkundur raportet e disa liderëve me popullin shqiptar. Pastaj vijnë raportet me ndërkombëtarët. Edhe në vitet e çlirimit, kur ne kërkonim pavarësi, faktori ndërkombëtar nuk ishte me ne. Por, ne qëndruam, luftuam dhe faktori ndërkombëtar, duke përfshirë ShBA-në, doli në anën tonë. Pra, fillimisht duhet të shikohen raportet me popullin.

"Epoka e re": E ka Kosova luksin që për shkak të taksës t'i sakrifikojë raportet me aleatët kryesorë të saj, me ndihmën e të cilëve ka arritur deri këtu?

Tahiri: Po them se gjithmonë faktori ndërkombëtar kur e sheh unitetin, vullnetin dhe historinë e popullit tonë,

gjithmonë e di kur është e drejta. Ndërsa individët që nguten të futen në lojëra të tilla ose nuk dinë se kah po shkon ky proces, ose e kanë ndarë mendjen ndryshe. Po e përsëris, fillimisht duhet parë interesi kombëtar, pastaj duhet punuar me faktorin ndërkombëtar që të respektohet interesi ynë kombëtar, siç është respektuar edhe në kohët më të vështira, kur askush nuk e njohte Kosovën. Kur kam dalë në diplomaci si ish-ministre e Jashtme në vitet '90 askush në diplomaci nuk e dinte se ku është Kosova. Por, tani jemi shtet i pavarur, me njohje të fuqishme dhe nuk duhet të lejuar që në emër të njohjes nga Serbia të japim verium e Kosovës. Ajo njohje dhe ai dialog fare nuk na duhet nëse na çon në një proces kundër interesave kombëtare.

"Epoka e re": Në anën tjetër, kemi kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, i cili pretendon që me anë të taksës do ta marrë njohjen nga Serbia. E shihni këtë si të mundshme?

Tahiri: Kjo është e thjeshtësuar si një analizë. Nuk është kaq e thjeshtë kjo punë. Me pas qenë kështu, kjo ka mundur të arrihet më herët. Lufta jonë tani është t'i mbrojmë kufijtë që t'ia bëjmë me dije Serbisë dhe Vuçiqit se kufijtë e Kosovës janë ta paprekshëm. Ëndrra e tyre që ta shfrytëzojnë edhe më tutje "Trepçën", duke marrë verium e vendit, ka përfunduar përgjithmonë. Po ashtu, lojërat e Rulisë që të rikthehen në Ballkan me fuqi gjeopolitike në dëm të tokave shqiptare, nuk do të ndodhë më. Prandaj, apeloj që subjektet politike ta arrijnë një unitet. Nuk pres që

ky unitet të arrihet 100 për qind, por forcat politike që e njohin interesin kombëtar dhe janë në mbrojtje të kufijve duhet të bashkohen.

"Epoka e re": Sa janë gjasat që gjatë këtij viti të kemi marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi?

Tahiri: Qëndrimi ynë si Kosovë duhet të jetë që të mos kemi marrëveshje në këtë kohë. Pra, të presim të shkojë Mogherini e cila ka tradhtuar parimet evropiane dhe t'i presim ndryshimet në udhëheqjen e BE-së. Shpresojmë të vij një udhëheqje që mbron parimet evropiane të integritetit të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, ashtu siç është konfirmuar edhe me strategjinë e fundit për zgjerim të BE-së.

PSD-ja dhe Nisma kërkojnë hise në KQZ

PRISHTINË, 27 MARS - Sot (e enjte) anëtarët e rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) do ta bëjnë betimin para presidentit Hashim Thaçi. Por ftesë për betim të përfaqësuesve të tyre në KQZ nuk kanë marrë Partia Socialdemokrate (PSD) dhe Nisma Socialdemokrate, të cilat pretendojnë se kanë hise në KQZ. Për këtë çështje këto dy parti kanë paralajmëruar se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Në një konferencë për medie, deputeti i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, ka thënë se kjo parti duhet ta ketë përfaqësuesin e vet në KQZ. "E dimë që është një vendim që lidhet me grupet parlamentare, por ai ka të bëjë me themelimin e institucioneve, ku shkruhet qartë Kuvendit dhe Qeverisë. Nuk flet për institucione të tjera. Një vendim i vitit të kaluar thotë se gjashtë grupet më të mëdha parlamentare duhet t'i dërgojnë përfaqësuesit e tyre në Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ). Neve na ka ardhur vendimi, ku është kërkuar që PSD-ja t'i nominojë përfaqësuesit e vet në KQZ. Besojmë, sipas interpretimit tonë të Kushtetutës, se neve na takon përfaqësimi në KQZ", ka thënë Molliqaj.

Edhe shefi i Grupit Parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka kërkuar nga



presidenti Hashim Thaçi që ta dekretojë kandidatin e kësaj partie në KQZ. "Ne kemi pasur ftesë për emërim, por jo për dekretim. Ne presim nga presidenti të na informojë pse procesi është ndërprerë pa i njoftuar palët", ka thënë Sherifi në një konferencë për medie.

Ai ka theksuar se ftesa e dërguar për PDK-në nuk është ftesë për koalicionin PAN, ku bëjnë pjesë AAK-ja dhe Nisma. "Ftesa dërguar PDK-së nuk është ftesë e dërguar për PAN-in dhe nëse presidenti e dekreton anëtarin e PDK-së si të PAN-it, atëherë ai bën shkelje të rëndë të procedurave për emërim në KQZ, sepse Kushtetuta njeh grupet parlamentare", ka thënë Sherifi, duke shtuar se nëse presidenti vepron ndryshe, rastin do ta dërgojnë

në Kushtetuese. "Ne gjithsesi rastin do ta dërgojmë në Kushtetuese. Tashmë në Kuvend janë PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma. Nëse në Kuvend nuk ka PAN atëherë kujt ia ka dërguar kërkesën?! Nëse ai mendon se PAN-i është PDK, unë i them se PAN-i nuk është PDK", është shprehur Sherifi.

Edhe Aleanca Kosova e Re (AKR) ka vlerësuar se ka të drejtë ta ketë një përfaqësues në KQZ. Sipas AKR-së, bazuar në Kushtetutë dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me këto emërim, kjo parti ka të drejtë ta emërojë anëtarin e saj nga grupi parlamentar LDK-AKR, pasi në zgjedhjet e vitit 2017 LDK-AKR kanë qenë të certifikuar në këtë mënyrë dhe po në këtë mënyrë edhe kanë marrë pjesë në seancën e parë (konstituive) të kësaj legjislature.

"Epoka e re": Zonja Tahiri, së fundi janë shtuar zërat brenda qeverisë që mendojnë se taksa ndaj mallrave serbe po e bllokton një marrëveshje të mundshme me Serbinë. Si i keni parë këto qëndrime?

Tahiri: Këto vlerësime vijnë nga ata që nuk janë në gjendje ta kuptojnë rrezikun në të cilin ndodhet Kosova në kuadër të dialogut të Brukselit. Taksa momentalisht është mekanizmi i vetëm që vret idenë e ndryshimit të kufijve. Me fjalë të tjera, i mbron kufijtë e shtetit të Kosovës sepse, siç e pamë të gjithë, Kuvendi i Kosovës dështoi që të krijojë një qëndrim të unifikuar të spektrit politik në një platformë. Pra, platforma u votua vetëm nga subjektet

Qalaj: Siguria në trafikun rrugor vazhdon të mbetet sfidë

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 27 MARS - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka raportuar të mërkurën në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, lidhur me raportin vjetor të punës për vitin 2018. Me këtë rast, ai paraqiti në mënyrë të përmbledhur aktivitetet, të arriturat dhe statistikat e angazhimit të policisë përgjatë vitit që lamë pas, po ashtu dha sqarime të shumta edhe në çështje të ndryshme që u ngritën nga anëtarë të Komisionit. Qalaj ka sqaruar se numri i veprave penale ka shënuar rënie për 0.60 për qind, ndërsa i personave të vdekur në aksidentet e trafikut rrugor ka shënuar rënie për 5.83 për qind. Po ashtu, numri i aksidenteve në trafikun rrugor ka shënuar rënie për 11.04 për qind. Ai ka vlerësuar se në bashkëpunim të ngushtë me qytetarët, por edhe me të gjitha institucionet vendore dhe

ndërkombëtare relevante në fushën e sigurisë, policia ka arritur rezultate të konsiderueshme në luftimin e dukurive shqetësuese të shoqërisë, përkundër sfidave të shumta të cilat janë paraqitur gjatë përmbushjeve të objektivave policore. "Gjatë vitit 2018 policia ka evidentuar gjithsej 46 841 raste. Prej tyre, 34 810 janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa 12 031 si kundërvajtje dhe raste të natyrave të tjera. Krahasuar me vitin 2017, numri i rasteve ka shënuar rënie për 4.82 për qind, numri i veprave penale po ashtu ka shënuar rënie për 0.60 për qind, rënie për 15.23 për qind ka shënuar edhe numri i kundërvajtjeve dhe raste të natyrave të tjera. Numri i vrasjeve ka shënuar ngritje, nga 27 në 32 ose ngritje për 18.51 për qind. Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar rënie për 4 për qind", ka thënë Qalaj, duke shtuar se numri i vjedhjeve ka shënuar ngritje për 1.86 për qind, e ndërsa numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar rënie për 8.57 për qind.



Qalaj ka folur edhe lidhur me sigurinë në trafikun rrugor, me ç'rast ka thënë se kjo çështje vazhdon të mbetet sfidë dhe për ta adresuar këtë sfidë, Policia e Kosovës në vazhdimësi po bën përpjekje të mëdha që të rritet siguria në trafikun rrugor. Krejt në fund, drejtori i policisë u

përgjigj edhe në pyetjet e shumta të anëtarëve të komisionit. Me theks të veçantë u diskutua lidhur me procesin e hetimeve në rastin "Drenasi", me ç'rast janë të përfshirë edhe zyrtarë policorë, si dhe për gradimet e policëve në këtë institucion. Pikë e rendit të ditës së mbledhjes së

sotme ishte edhe shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës si dhe formimi i panelit për zgjedhjen e komisionarit për mbrojtjen e të dhënave personale, mirëpo këto çështje janë shtyrë për mbledhjen e radhës.

Ministri Bytyqi kërkon gjithëpërfshirje për ta bërë arsimin prioritet numër një në Kosovë



PRISHTINË, 27 MARS (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të mërkurën në prezantimin "Të arriturat në sektorin e arsimit fillor në Kosovë 2010-2018 dhe synimet për të ardhmen", ku u shpalsën të gjeturat në sektorin e arsimit fillor në fushat: transparencja dhe llogaridhënia, gjithëpërfshirja, ngritja e kapaciteteve të udhëheqësve arsimorë dhe cilësia e mësimdhënies. Ministri Bytyqi në këtë konferencë

foli për rëndësinë e ndryshimit të qasjes së mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe të gjitha palëve të interesit dhe veprimin e tyre së bashku, për ta bërë arsimin prioritetin numër një në Kosovë. Ministri Bytyqi me këtë rast falënderoi GIZ-in për angazhimin e jashtëzakonshëm, si një nga partnerët kryesor në reformat e nevojshme në sistemin arsimor, përmes përvajave dhe praktikave të mira të sistemit arsimor të Gjermanisë. "MASHT-i në bashkëpunim me partnerët e saj

ka punuar që arsimi në Kosovë të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe kualitativ. Gjermania na ka mbështetur në këtë drejtim, por ende kemi nevojë për përkrahjen e saj në hapat që na presin", ka thënë ministri Bytyqi. Në konferencën ku u prezantuan të gjeturat në sektorin e arsimit në Kosovë brenda periudhës 2010-2018, të pranishëm ishin edhe Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit Parlamentar të Arsimit dhe David Oberhuber, drejtor i Zyrës së GIZ-it në Kosovë.

Ministrja Hoxha: Gratë në vendimmarrje duhet të jetë rregull, jo përjashtim

PRISHTINË, 27 MARS (ER) - Rrjeti i Grave të "Business Forum Prizren" ka organizuar mbledhjen e radhës me temë "Fuqizimi i grave në vendimmarrje", ku ishin të pranishme ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, aktivistja e të drejtave të grave dhe këshilltarja politike, Valdete Idrizi, nënkryetarja për komunitete nga Komuna e Prizrenit, Memnuna Ajdini, si dhe anëtare të këtij forumi dhe aktiviste nga Prizreni dhe më gjerë. Ministrja Hoxha ka thënë se gratë në vendimmarrje duhet të jetë rregull, jo përjashtim. "Barazia gjinore është vlerë thelbësore e

demokracisë, andaj gratë në vendimmarrje janë pjesë e të arriturave të çdo shteti demokratik. Gratë në vendimmarrje duhet të jetë rregull, jo përjashtim. Fuqizimi i grave në vendimmarrje do të jetë vlera më e qëndrueshme për proceset që po kalojmë deri në integrimin e plotë euroatlantik", është shprehur ajo. Hoxha ka theksuar se gratë janë shtylla e shtëpisë dhe e shtetit. "Kjo nuk do mend, por duhet të japim shembuj se vërtet duam edhe familje, edhe shtet me shtylla të forta. Thjesht, zgjidhja është e lehtë duke u fuqizuar gratë në vendimmarrje", ka deklaruar Hoxha.



Rrahim Hashimi, i ftuari i radhës nga Gjykata Speciale

Rrahim Hashimi, ish-pjesëtar i Brigadës 138 "Agim Ramadani" të UÇK-së, është i ftuari i radhës nga Gjykata Speciale. Ai do të paraqitet para këtij trupi gjykes me 9 prill të këtij viti. Në një konferencë për media, Hashimi ka bërë me dije se do t'i përgjigjet kësaj ftese



në asnjë krim. "Personalisht nuk kam qenë i përfshirë në ndonjë krim dhe as që kam njohuri për ndonjë krim të kryer", ka theksuar ish-luftëtari i UÇK-së, Rrahim Hashimi.

Ai ka bërë me dije se nuk do të marrë avokat mbrojtës në këtë fazë dhe ka pasur një kërkesë për media. "Me mirësjellje ju lus

që për çdo gjë dhe për ecurinë e procesit t'i drejtoheni OVLUÇK-së. Kërkoj që të mos më bezdisni mua apo familjarët e mi", ka thënë Rrahim Hashimi.

Kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë se vendimet për paraqitjen në intervistime janë individuale dhe se deri më sot është vetëm një rast që ka

refuzuar ftesën e Gjykatës Speciale. "Ne nuk e njohim këtë gjykatë, por i mbetet secilit të vendosë veç e veç. Mirë është t'i përgjigjemi. Lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe e pastër. Ne nuk i frikësohemi drejtësisë dhe veteranët do ta bëjnë më të mirën e mundshme", ka thënë Gucati.

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 MARS - Rrahim Hashimi, ish-luftëtar i "Forcave Komando Delta" të UÇK-së, Brigada 138 - ZOD, është ftuar nga Gjykata Speciale në cilësinë e të dyshuarit. "Jam ftuar nga prokurori i Dhomave të Specializuara në Hagë për t'u intervistuar në cilësinë e të dyshuarit dhe duhet të paraqitem më 9 prill në Hagë", ka thënë Rrahim Hashimi të mërkurën në një konferencë për media në selinë qendrore të OVLUÇK-së në Prishtinë. Ai ka thënë se, pavarësisht prej votimit të padrejtë nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës për Ligjin e Dhomave të

Veçanta, ai do t'i përgjigjet pozitivisht kësaj ftese. "Do t'i respektoj ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës për aq kohë sa janë në fuqi këto ligje", ka thënë ai.

Ai ka thënë se hipotetishtë mund të dyshohet për shkelje të disiplinës ushtarake apo tejkallim të autorizimeve ushtarake. "Nuk jam intervistuar asnjëherë që nga lufta e deri më sot, madje ende s'jam i intervistuar ndonjëherë për ndonjë krim lufte apo të ngjashme. Avokat mbrojtës në këtë fazë nuk do të marrë sepse s'kam asnjë arsye t'i justifikoj veprimet e mia të luftës", ka theksuar Hashimi.

Ai ka pohuar se gjatë luftës çlirimtare nuk ka qenë i përfshirë

Fillojnë përgatitjet për regjistrimin e dytë të popullsisë në Kosovë

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka takuar të mërkurën një delegacion nga Eurostat, me të cilin ka diskutuar për përgatitjet për regjistrimin e popullsisë më 2021. Po ashtu, Hoxhaj ka nënshkruar edhe memorandum mirëkuptimi në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve - UNOPS, për regjistrimin e popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare në Kosovë



EPOKA
ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 27 MARS - Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, ka pritur të mërkurën në takim zyrtar drejtorin e përgjithshëm për Bashkëpunim dhe Koordinim Statistikor në Eurostat, Eduardo Barredo Capelot, me të cilin kanë diskutuar lidhur me përgatitjet për regjistrimin e dytë të popullsisë në Kosovë në vitin 2021. Duke e falënderuar për mbështetjen dhe bashkëpunimin, Hoxhaj e ka njoftuar drejtorin e përgjithshëm për bashkëpunim dhe koordinim statistikor, në lidhje me punën që është bërë deri më tani në funksion të përgatitjes sa më të mirë të procesit të regjistrimit të popullsisë, duke theksuar se miratimi i Ligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave është në proces e sipër. "Në takim me drejtorin e Përgjithshëm për Bashkëpunim dhe Koordinim Statistikor të

Eurostatit, Eduardo Barredo Capelot, kemi diskutuar në lidhje me përgatitjet për regjistrimin e dytë të popullsisë më 2021. E informova në lidhje me punën që kemi bërë deri më tash në drejtim të përgatitjes sa më të mirë të procesit, si dhe e falënderova për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin me Kosovën përmes Agjencisë së Statistikave", ka thënë zëvendëskryeministri Hoxhaj.

Ai e ka informuar delegacionin nga Eurostat edhe për plotësimit të Ligjit për Statistika Zyrtare të Republikës së Kosovës, në përputhshmëri me Rregulloren e Parlamentit Evropian, Këshillin mbi Statistikat Evropiane, si dhe me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. Po të mërkurën Hoxhaj ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve - UNOPS, për regjistrimin e popullsisë, banesave dhe ekonomive famil-

jare në Kosovë, projekt ky që pritet të nisë në vitin 2021. Projektin e implementon Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK-ja).

Me rastin e nënshkrimit të memorandumit, zëvendëskryeministri Hoxhaj ka thënë se ky proces është me rëndësi kapitale, andaj duhet një angazhim i të gjithëve që të realizohet me profesionalizëm të lartë dhe sipas standardeve ndërkombëtare, të jetë kredibil si në aspektin nacional, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Sipas memorandumit të nënshkruar, Agjencia e Statistikave të Kosovës si bartëse e projektit do ta zbatojë projektin në bashkëpunim të ngushtë me UNOPS-in, i cili do të menaxhojë fondin e krijuar për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të projektit. "Fondi do të menaxhohet si program, gjegjësisht Multi Partner Fund, në të cilin, krahas Qeverisë së Kosovës, do të bashkohen edhe partnerë dhe donatorë të tjerë potencialë ndërkombëtarë, siç janë: Zyra e BE-së, Swiss Development

Cooperation, Qeveria e Gjermanisë, Qeveria e Suedisë - SIDA, Qeveria e Norvegjisë, e Luksemburgut, e Danimarkës, si dhe përfaqësitë e qeverive të tjera dhe donatorët e tjerë në Kosovë", ka thënë zëvendëskryeministri Hoxhaj.

Projekti do të qeveriset përmes Bordit të Projektit, gjegjësisht Komitetit Drejtues, anëtarë të të cilit do të ishin të gjithë pjesëmarrësit në fond. Qeveria e Kosovës do të financojë 40 për qind të projektit dhe partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë 60 për qind.

BQK-ja dhe Eurostati diskutuan lidhur me zhvillimin e sistemit statistikor të Kosovës

PRISHTINË, 27 MARS (ER) - Zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për Mbikëqyrje Financiare, Sokol Havolli, ka takuar të mërkurën një delegacion të lartë të Eurostatit për të diskutuar mbi statistikat dhe çështjet përkatëse që kanë të bëjnë me informacionin statistikor në Kosovë. Zëvendësguvernatori Havolli i ka informuar zyrtarët e Eurostatit lidhur me progresin e bërë nga BQK-ja në vitet e fundit për të zhvilluar një sistem të qëndrueshëm statistikor, që prodhon statistika cilësore të nevojshme për procesin e vendimmarrjes. Me këtë rast, zëvendësguvernatori Havolli ka potencuar se fokusi i BQK-së është në statistikat e sektorit monetar dhe financiar, sektorit të jashtëm dhe në statistikat e sektorit të llogarive financiare. "Ne jemi të vetëdijshëm se pa statistika të shëndosha nuk mund t'i monitorojmë zhvillimet ekonomike e as të nxjerrim politika ekonomike të mira", ka thënë Havolli.

Ai ka theksuar se BQK-ja që nga themelimi i saj ka punuar në tri elemente kryesore për të ndërtuar një sistem të mirë statistikor.



"Kemi investuar në ngritjen e kapaciteteve për t'iu përgjigjur kërkesave për të dhëna me cilësi të lartë dhe në kohë; gjithmonë kemi zbatuar metodologjitë e fundit ndërkombëtare për përpilimin e të dhënave që janë në domenin e BQK-së; dhe kemi ndërtuar një sistem efikas të

publikimit të shpërndarjes së të dhënave që prodhohen nga BQK-ja", ka thënë zëvendësguvernatori Havolli.

Havolli ka falënderuar Eurostatin për mbështetjen konstruktive për avancimin e sistemit statistikor të Kosovës dhe se BQK-ja është e gatshme ta

forcojë më tutje këtë bashkëpunim për të dërguar më shumë të dhëna për Kosovën në Eurostat.

Përfaqësuesit e Eurostatit, të kryesuar nga Eduardo Barredo Capelot, drejtor për Bashkëpunim Statistikor në Eurostat, falënderuan zëvendës-

gubernatorin Havolli për informimin. Ata shprehën gatishmërinë për përkrahjen e mëtejme të BQK-së dhe Kosovës në përgjithësi, për zhvillimin e mëtejme të sistemit statistikor dhe për harmonizimin e plotë të statistikave në përputhje me EU acquis.

Haradinaj kërkon seancë më 3 prill për projektligjin që ndalon lojërat e fatit



PRISHTINË, 27 MARS (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se e ka dorëzuar kërkesën në Kuvendin e Kosovës për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme më 3 prill për çështjen e projektligjit që ndalon lojërat e fatit. "Pas diskutimit dhe procesimit nga ana e Qeverisë për në Kuvendin e Kosovës të Projektligjit për ndalimin e lojërave të fatit, sot e kam dërguar në Kuvendin e Kosovës kërkesën për Seancë të Jashtëzakonshme më datë 3 prill 2019 për shqyrtimin e këtij

projektligji", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar të martën Projektligjin për ndalimin e lojërave të fatit në afat prej 10 vjetësh. Sipas projektligjit, ndalohen të gjitha lojërat e fatit, me përjashtim të Lotarisë së Kosovës, dhe shfuqizohet Ligji për Lojërat e Fatit dhe aktet nënligjore që janë nxjerrë për zbatimin e tij. Ligji do të hyjë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës.

Bekim Millaku, ushtrues i detyrës së drejtorit të AKK-së

PRISHTINË, 27 MARS (ER) - Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK) ka zgjedhur Bekim Millaku ushtrues të detyrës së drejtorit të përgjithshëm të këtij autoriteti. Lajmin e ka konfirmuar kryetari i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Valon

Prestreshi, nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook". "Miq të dashur, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës zgjodhi u. d. të drejtorit të përgjithshëm të AKK-së, z. Bekim Millaku. Na pret një punë e madhe", ka shkruar Prestreshi.



Veseli kërkon bashkëpunim më të madh midis institucioneve dhe odave ekonomike

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në konferencën "Dialogu publiko-privat në funksion të zhvillimit të sektorit privat", ka kërkuar bashkëpunim më të madh midis institucioneve dhe odave ekonomike. Ndërkaq ministri i Financave, Bedri Hamza, ka folur për lehtësirat që qeveria ka krijuar për bizneset në vitet e fundit dhe për impaktin pozitiv që ato kanë pasur në zhvillimin e tyre

bashkërisht për të diskutuar dhe për t'i bërë përpjekjet publike për modernizimin e ekonomisë së Kosovës. Institucionet e Kosovës dhe përfaqësuesit e ndërmarrësisë mund të arrijnë të zhvillojnë një ekonomi shumë më kontribuuese. Nëse vazhdojmë kështu, rrezikohet rinia dhe mund të kemi degradim demografik. Kam pritur që odat ekonomike të jenë më influencuese.

Odat ekonomike mund t'i përcaktojnë politikat tona dhe tani kemi disa iniciativa dhe kjo është shumë mirë", ka thënë kryeparlamentari Veseli. Kreu i legjislativit të Kosovës ka bërë me dije se janë në procedurë një varg projektligjesh të cilat lehtësojnë veprimtar-

inë prodhuese dhe biznesore. Në funksion të kësaj, Veseli ka pohuar se çdo iniciativë e odave ekonomike të Kosovës do ta gjejë përkrahjen e institucioneve ngaqë, siç ka thënë ai, nuk ka asgjë më prioritet sesa zhvillimi ekonomik.

Ndërkaq, ministri i Financave, Bedri Hamza, ka folur për lehtësirat që qeveria ka krijuar për bizneset në vitet e fundit dhe për impaktin pozitiv që ato kanë pasur në zhvillimin e tyre. Hamza ka thënë se punëdhënësi më i madh në Kosovë është sektori privat, rrjedhimisht edhe kontribuuesi kryesor i zhvillimit ekonomik të vendit.

Ndërsa ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se është i lumtur që sot Kosova

ka arritur të marrë një drejtim të mirë me gjykatën komerciale. Ai ka thënë se kjo gjykatë do të jetë adresë e cila do ta rrisë efikasitetin e drejtësisë për bizneset.

Kryetari i Odës Ekonomike, Berat Rukiqi, i cili njëherësh moderoi konferencën, ka thënë se me politikat publike ka lëvizje të qartë të fuqisë punëtore drejt vendeve të tjera. Ai e konsideroi të domosdoshme ndërmarrjen e masave për ndalimin e kësaj ikjeje, duke krijuar kushte për punë brenda Kosovës. Konferenca, e cila është organizuar nga Zyra e Komunitetit të Biznesit në kuadër të Kuvendit të Kosovës, po vijon punimet me diskutime të përfaqësuesve të bizneseve.

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 27 MARS - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, të mërkurën, në konferencën "Dialogu publiko-privat në funksion të zhvillimit të sektorit privat", ka thënë se Kosova si shtet i pavarur dhe

soveran, përveç qëndrueshmërisë institucionale, duhet të ketë edhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Duke kërkuar bashkëpunim më të madh midis odave ekonomike dhe institucioneve, kryeparlamentari Veseli ka thënë se ka pritur ndikim më të madh të shoqatave të bizneseve. "Sot jemi këtu



Balija: Digjitalizimi është bërë fenomen global në industrinë bankare



PRISHTINË, 27 MARS (ER) - Shoqata e Bankave të Kosovës (ShBK), në bashkëpunim me "Kobil Systems", organizuan punëtorinë me temë "Si të bëhet një bankë plotësisht e digjitalizuar". Në fjalën e tij hyrëse kryeshefi ekzekutiv i Shoqatës së Bankave, Petrit

Balija, ka thënë se kjo punëtori është mundësi e mirë që bankat dhe Banka Qendrore e Kosovës të diskutojnë mbi zhvillimet e fundit në këtë fushë, në mënyrë që, sipas tij, rregullativa përkatëse dhe ofrimi i shërbimeve financiare të jenë të harmonizuara. "Digjitalizimi

është bërë një fenomen global që po transformon mënyrën se si veprojnë bankat, si ato angazhohen me klientët, produktet dhe shërbimet e tyre. Andaj Shoqata e Bankave të Kosovës vazhdon t'i ofrojë mundësitë e tilla të diskutimit sektorial", ka thënë Balija.

Sot mbahet sesioni informues rreth programit për grante të përputhshme

GJAKOVË, 27 MARS (ER) - Komuna e Gjakovës ka njoftuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) në përmjet Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) dhe Grupit të Bankës Botërore me "Projektin e Konkureshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport (CERP)", nënkomponenti 1.2 i CERP-it, përkrahja e bizneseve për ta përmirësuar cilësinë e produktit dhe gatishmërinë për eksport, do ta hapë thirrjen për aplikim për Programin e Granteve të

Përputhshme (PGP). Sesioni informues rreth këtij programi do të mbahet sot (e enjte) në Kuvendin Komunal të Pejës. Qëllimi i këtij programi ka të bëjë me ndihmën ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe shoqatave të biznesit për standardet/certifikimin e produkteve si dhe shërbimet e zhvillimit të biznesit. Të pranishëm në këtë sesion informues do të jenë përfaqësuesit nga njëjësia menaxhuese e GP-së si dhe përfaqësues nga KIESA.



Dhjetë fshatra të Skenderajt bëhen me ujësjellës

SKENDERAJ, 27 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jean Hubert Lebet, dhe kryeparlamentarin Kadri Veseli, kanë përfunduar të mërkurën projektin e sistemit të ujësjellësit, nga i cili do të përfitojnë 10 mijë banorë nga dhjetë fshatra të kësaj komune. Në emër të Skenderajt, Jashari ka falënderuar qeverinë zvicerane për financimin e këtij projekti. "Jam tejet i lumtur që sot së bashku me ambasadorin zviceran Jean Hubert Lebet dhe kryeparlamentarin Kadri Veseli përfundim projektin më vital për qytetarët e komunës sonë, siç

është ky i sistemit të ujësjellësit, nga i cili do të përfitojnë 10 000 mijë banorë, nga dhjetë fshatra të Skenderajt, përfshirë Qubrelin, Kllodernicën, Kopiliqin e Epërm, Kopiliqin e Poshtëm, Kostërcin, Rakinicën, Turiqecin, Tushilën, Vajnikun dhe një pjesë të fshatit Kërnice, projekt ky në vlerë prej 1 230 mijë eurosh. Në emër të qytetarëve të komunës sonë, veçanërisht banorëve përfitues, falënderoj Qeverinë e Zvicrës dhe të Kosovës, si financues të këtij projekti, nëpërmjet programit mbështetës për ujësjellës dhe kanalizime në zonat rurale të fazës së pestë", ka thënë Jashari.

Po ashtu, ai ka falënderuar edhe impelmentuesin e këtij projekti, i cili, sipas tij, ka bërë një punë të shkëlqyeshme. "Shprehim falënderim të veçantë edhe për implementuesin - konsorciumin 'Dorsch/CDI', i cili ka bërë një punë të shkëlqyer dhe duhet marrë shembull se si duhet të realizohen projektet. Shumë shpejt do të nisim projektin tjetër të ngjashëm, faza e VI, me të njëjtit donatorë, nga i cili do të përfitojnë fshatrat: Açarevë, Abri e Poshtme, Likoc, Llaushë, Makërma, Marinë, Murgë, Plluzhinë, Rezallë, Ticë e Izbicë. Ditë të mira po vijmë për Skenderajt", ka deklaruar Jashari.



Gjilani rrënon një objekt pa leje në pronën komunale

GJILAN, 27 MARS (ER) - Komuna e Gjilanit, respektivisht Drejtoria e Inspeksionit, ka bërë rrënimin e objektit të ndërtuar në pronën komunale në lagjen "Arbëria". Kjo komunë ka theksuar se do të vazhdojë rrënimin e të gjitha ndërtimeve-uzurpimeve të pronës komunale. Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit, Nevzad Rushiti, ka potencuar se uzurpimi i pronës komunale dhe ndërtimi pa leje

është një vepër e rëndë që, krahas kësaj, çdo shkelës i këtyre rregullave, përpos rrënimin, mund të përballet edhe me organet e drejtësisë. "Sot jemi në lagjen 'Arbëria', ku kemi bërë rrënimin e objektit i cili po ndërtohej në pronë publike. Në këtë hapësirë do të bëhet ndërtimi i stadiumit ndihmës të futbollit. Mirëpo, krahas këtij veprimi të ndërmarrë ndaj këtij objekti, inspektorët janë vazhdimisht në terren dhe po

zbatojnë detyrën zyrtare konform ligjit, duke bërë shiritime, procesverbale, ndërprerje të punimeve e deri te rrënimet sikur rasti i sotëm", ka thënë Rushiti, i cili u ka bërë apel qytetarëve të jenë vigjilentë, sepse blerja e pronës komunale nga kushdo qoftë apo edhe investimi në ndërtim janë vepra penale dhe, përpos humbjeve të tyre materiale, çdo shkelës do të përballet me organet e drejtësisë.

Suhareka ndalon shitjen e zhavorrit vend e pa vend

SUHAREKË, 27 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se tash e tutje nuk do të lejohet shitja e zhavorrit vend e pa vend. Ai ka thënë se kjo komunë ka caktuar lokacionin se ku mund të shitet

zhavorri. "Tash e tutje lokacioni është i caktuar me vendim për shitjen e druve dhe zhavorrit. Më nuk lejohet shitja në zona vend e pa vend. Hapësira është e rregulluar dhe gjithçka do të funksionojë më mirë", ka thënë Muharremaj.



Në Ditën Botërore të Teatrit, ministri Gashi dha çmimet për teatër

Çmimi Kombëtar për Vepër Jetësore iu dha aktorit Sabedin Shahiqi. Aktori Shahiqi ka kontribuar në zhvillimin e teatrit në Kosovë. Që nga viti 1971 e deri më sot ai ka luajtur në katër role në teatër, film dhe televizion. Shumica prej tyre ishin role bartëse

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 27 MARS - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në një ceremoni solemne në kabinetin e tij, ka bërë ndarjen çmimeve për teatër për vitin 2018. Çmimet e ndara u shoqëruan me certifikata dhe me shpërblime në vlera monetare ku, përveç Çmimit Kombëtar për Vepër Jetësore që u shpërblye me shumën prej 5 000 eurosh, çmimeve të tjera iu ndanë nga 2 500 euro.

Çmimi Kombëtar për Vepër Jetësore iu dha aktorit Sabedin Shahiqi. Aktori Shahiqi ka kontribuar në zhvillimin e teatrit në Kosovë. Që nga viti 1971 e deri më sot ai ka luajtur në katër role në teatër, film dhe televizion. Shumica prej tyre ishin role bartëse.

Ndërkaq, Çmimi Vjetor për Shfaqjen më të Mirë iu nda Teatrit Kombëtar të Kosovës për shfaqjen "Arturo Ui". Kjo shfaqje është një vepër e jashtëzakonshme që korrespondon me realitetin në të cilin kalon Kosova. Shfaqja kalon finesë, thellësi, guxim dhe art të nivelit të lartë.

Çmimi Vjetor për Regjinë më të Mirë iu nda regjisorit Bekim Lumi - "PostMortem", për regjinë e shfaqjes "Arturo Ui" - Teatri Kombëtar i Kosovës. Sukses i kësaj shfaqjeje është arritur kryekëput në saje të regjisë së nivelit të lartë, ku regjisor i Lumi ka dëshmuar profesionalizëm dhe inovacionin e sjellë në skenë në mënyrë mjeshtërore.

Çmimi Vjetor për Aktorin më të Mirë iu dha aktorit Mentor Zymberaj për rolin e "Hamletit" në shfaqjen "Ëndërrta e Hamletit". Mentor Zymberaj në



rolin e "Haltetit" u vlerësua, u nderua dhe u shpërblye për lojën e tij brilante.

Për Çmimin Vjetor për Prezantim të Suksesshëm Ndërkombëtar, për vitin 2018, kishte vetëm një nominim dhe ky çmim iu nda Shtëpisë Teatrorë Filmike - AKT. AKT realizoi tetë prezantime ndërkombëtare në festivale prestigjioze.

Pas ndarjes së këtyre çmimeve, ministri Gashi u prononcua për medie, ku ndarjen e këtyre

çmimeve e vlerësoi si një lloj respekti dhe mirënjohjeje nga ana e institucioneve për angazhimin dhe punën kreative të artistëve. Ai i ka inkurajuar artistët të vazhdojnë edhe më tutje me punë dhe angazhim. "Ne si ministri po përipiqemi t'i ndajmë çmimet për çdo fushë që ka të bëjë me kulturë me qëllim që t'ju mbështesim dhe inkurajojmë që me punë dhe angazhim ta mbani gjallë kulturën e vendit tonë. Ne si shtet jemi me fat që


kemi shumë krijues dhe artistë të cilët me punën po na promovojnë shtetin, ë të njëjtën kohë po na bëjnë krenarë", ka thënë Gashi. Ndërkaq fituesit e këtyre çmimeve falënderuan ministrin Gashi për përkrahjen e vazhdueshme dhe për marrjen e çmimeve. Edhe ata shpërblimet i vlerësuan si një mirënjohje institucionale dhe inkurajim për të punuar edhe më shumë në krijimtarinë e tyre artistike.

'Libri i luftës' prezanton edhe mbështetjen e maturantëve të Gjinnazit 'Xhevdet Doda' të Prishtinës dhënë UÇK-së më 1998 dhe 1999

PRISHTINË, 27 MARS (ER) - Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Prekaz më 5, 6 dhe 7 mars, rënia e komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, betejat e mëpastajme të UÇK-së dhe krijimi i territoreve të lira, në vitin 1998 në mesin e të rinjve të Prishtinës, në mënyrë të veçantë në mesin e nxënësve të Gjinnazit "Xhevdet Doda", kishin krijuar vetëdije të lartë kombëtare për ta mbështetur luftën tonë për liri.

Në shtator të vitit 1998 maturan-tët e gjeneratës 1998-1999 e bënë atë që nuk e kishte bërë gjenerata e kaluar e maturan-tëve: u vendosën tërësisht në mbështetje të UÇK-së.

Udhëheqja e rinisë shkollore, në të cilin bënin pjesë Samire Ademi, Besfort Rrecaj dhe nxënës të tjerë të kësaj gjenerate, si dhe udhëheqja e revistës shkollore "Gjinnazisti", Fiton Peja, Arianit Bytyçi, Bujar Sadiku, Arbëresha Selimaj, Kreshnik Gashi, Kushtrim Berisha, Krenare Sogojeva, Ermal Sadiku, Vegim Beqiri, Milot Goçi, Sandro Deva dhe nxënës të tjerë, të mbështetur nga drejtori i shkollës, profesori Binak Ulaj dhe profesorët Sahit Berisha dhe Shyqri Obërtinca, organizuan tryezën në mbështetje të UÇK-së, ku ftuan profesorë, politologë, liderë të lëvizjes studentore dhe intelek-



tualë të tjerë. Madje Arianit Bytyçi, Bujar

Sadiku, Albana Rexhepi e Kushtrim Berisha kishin vizituar zonat e lira të kontrolluara nga UÇK-ja, pastaj bashkë me Fiton Pejën në mënyrë të hapur, duke publikuar emrat dhe mbiemrat e tyre, në "Gjinnazisti" dhe gazetën e studentëve "Bota e Re" kishin botuar shkrime afirmative dhe mbështetëse për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Për këtë mbështetje të hapur të maturantëve të Gjinnazit "Xhevdet Doda" të Prishtinës ata morën një mesazh falënderues nga njëri prej komandantëve të UÇK-së, anëtari i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Fatmir Limaj, e cila asokohe u botua në revistën "Gjinnazisti".

Tani në prag të 20-vjetorit të maturës së këtij brezi, të gjitha këto sakrifica janë të shkruara në mënyrë të detajuar dhe të ilustruara me fotografi në "Librin e luftës" të autorit Nuhi Bytyçi. "Librin e luftës" mund ta porosisni përmes kësaj faqeje, si dhe mund ta blini në libraritë "Dukagjini", "Artini" dhe "Buzuku" në Prishtinë, në librarinë "Altera" në Prizren, në librarinë "Dukagjini" në Pejë, në librarinë "Rilindja" në Ferizaj, në librarinë "ABC" në Gjiilan, në librarinë "Galdimi" në Mitrovicë, në "Migros" në Vushtrri, në Aeroportin e Prishtinës, si dhe në libraritë e qyteteve të tjera të Kosovës.

Fillojnë vizitat sistematike shëndetësore të nxënësve në Komunën e Prizrenit

PRIZREN, 27 MARS (ER) - Drejtorja e Shëndetësisë në Prizren, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit dhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, të mërkurën kanë filluar vizitat sistematike shëndetësore të nxënësve të klasës së parë, të pestë dhe të nëntë. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher

Haskuka, së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, Visar Shehu, drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, Skënder Susuri dhe stafin menaxhues të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, vizituan Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Mustafa Bakiu", për të parë nga afër këtë proces. Qëllimi i

këtyre vizitave është identifikimi dhe parandalimi i hershëm i problemeve shëndetësore që iu paraqiten fëmijëve. Në kuadër të këtyre vizitave do të realizohen rreth 35 matje të ndryshme, si matja e peshës, e gjatësisë, e kontrollit të eshtrave, kontrolli stomatologjik, të të pamurit si dhe zhvillimi i përgjithshëm i fëmijëve.



Ligjvënësit britanikë votojnë për alternativat për daljen nga BE-ja

LONDËR, 27 MARS - Ligjvënësit britanikë po përgatiten të votojnë rreth disa alternativave për shkëputjen e vendit nga Bashkimi Evropian, në një përpjekje për t'i dhënë fund një situatë bllokimi pas disfatës së fortë që pësoi marrëveshja e negociuar nga kryeministria Theresa May.

Dhoma e Komuneve pritet të debatojë rreth alternativave të ndryshme, proces pas të cilit do të kërkohet që ligjvënësit të votojnë për të gjitha opsionet. Propozimet më të përkrahura do

të kalojnë në një votim të dytë të hënën, me shpresën për të gjetur një variant që mund ta fitojë shumicën.

Debati vjen dy ditë pasi ligjvënësit i morën qeverisë kontrollin e agjendës parlamentare, në klimën e shqetësimeve se May nuk ishte e gatshme për kompromis. Kryeministria ka thënë se do ta shqyrtojë rezultatin e votimit të të gjitha alternativave, por se nuk është e detyruar ta njohë atë.

Qeveria shpreson ende që të sjellë në Dhomën e Komuneve marrëveshjen e kryeministres

May për divorcin nga BE-ja, marrëveshje e cila nuk gëzon mbështetje. Kryetarja e kësaj dhome, Andrea Leadsom, tha se ekziston një mundësi "e mirë" që marrëveshja të shqyrtohet sot (e enjte) ose nesër (e premte). "Jemi plotësisht të vendosur të sigurohemi që mund të marrim mbështetje të mjaftueshme për ta kthyer sërish atë për votim", tha Leadsom, duke shtuar se marrëveshja e May është e vetmja mënyrë që garanton largimin e Britanisë nga BE-ja.

Disa kundërshtarë thonë se mund



të mos votojnë për marrëveshjen për shkak të frikës se bllokimi i krijuar në parlament do të çonte në vonimin apo braktisjen e Brexitit.

Demokratët këmbëngulin për publikimin e raportit të prokurorit Mueller

Demokratët thonë se raporti i plotë mund të ndihmojë në zgjidhjen e pikëpyetjeve të mbetura lidhur me vendimin e Muellerit për të mos e nxjerrë plotësisht pa faj presidentin Trump në çështjen e pengimit të drejtësisë, madje edhe tani që ata po përpiqen të fokusohen te politika e përditshme



UASHINGTON, 27 MARS - Demokratët e Kongresit kërkuan të martën publikimin e raportit të prokurorit të posaçëm Robert Mueller, duke thënë se publiku amerikan meriton t'i dijë hollësitë e hetimit, i cili nuk gjeti asnjë bashkëpunim të fshehtë midis fushatës Trump dhe Rusisë në zgjedhjet e 2016-s. Publikimi i raportit të plotë mund të ndihmojë që t'i jepet përgjigje pyetjes se përse Muelleri në raportin e tij nuk përjashtoi mundësinë e një akuze për pengim të drejtësisë kundër presidentit Trump.

Rezultatet e raportit të Muellerit tashmë dihen, por vetëm të përmbledhura. Prokurori i Përgjithshëm Barr duhet të veprojë me kujdes përpara se ta publikojë atë të plotë, thanë republikanët. "Inkriminimi i njerëzve të pafajshëm apo bërja publike e dokumenteve të klasifikuara nuk më duket ide e mirë. Kam besim se prokurori i përgjithshëm do ta mbajë parasysh këtë", thotë Mitch

McConnell, udhëheqës i shumicës në Senat.

Por pa pasur raportin e plotë, demokratët thonë se është e pamundur të merret një vendim i informuar. "Nuk kam nevojë për interpretimin e raportit nga prokurori i përgjithshëm Barr. Unë kërkoj raportin. Kërkesa jonë kryesore për këtë çështje është transparenca, të publikohet raporti, pastaj të nxirren përfundime", thotë Chuck Schumer, udhëheqës i pakicës në Senat.

Kryetarët e gjashtë komisioneve të Dhomës së Përfaqësuesve, e kontrolluar nga demokratët, kërkuan zyrtarisht nga Barr ta dorëzojë raportin deri më 2 prill. Nëse ai nuk e bën, një ligjvënës aludoi kështu për hapat e ardhshëm. "Si komision ne kemi kompetencë ta kërkojmë dorëzimin e dokumentit. Sinqerisht, nuk shoh asgjë në rregulloret për prokurorin e posaçëm që ta ndalojë kreun e Departamentit të Drejtësisë ta publikojë

raportin", thotë Sheila Jackson Lee, ligjvënësja demokrate.

Raporti i Muellerit u prit mirë nga presidenti Trump, i cili tha se kjo i jep fund debatit të ngritur nga disa demokratë për mundësinë e nisjes së një procesi për shkarkimin e presidentit. "Nuk më duket se po e përmendim më temën e shkarkimit. Ne kemi ekonominë më të madhe që kemi pasur ndonjëherë, vendi është në formë të shkëlqyer. Ata dhe të tjerët

krijuan një mashtrim në vendin tonë me këtë gjueti qesharake shtrigash ku u provua fuqishëm se nuk ka pasur asnjë bashkëpunim, asnjë pengim, asgjë", thotë presidenti Trump.

Demokratët thonë se raporti i plotë mund të ndihmojë në zgjidhjen e pikëpyetjeve të mbetura lidhur me vendimin e Muellerit për të mos e nxjerrë plotësisht pa faj presidentin Trump në çështjen e pengimit të drejtësisë, madje edhe tani që

ata po përpiqen të fokusohen te politika e përditshme. "Demokratët janë përqendruar te çështjet e përditshmërisë, tek ulja e kostos së kujdesit shëndetësor apo te rritja e pagës për amerikanët e thjeshtë", thotë demokrati Hakeem Jeffries. Megjithatë, ata vazhdojnë hetimet për aktivitetet e tjera të presidentit Trump, siç janë deklaratimet e tij tatimore dhe marrëdhëniet e biznesit me të huajt.

KS i OKB-së do ta diskutojë vendimin e ShBA-së për Rrafshnaltën Golan

NJU JORK, 27 MARS - Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara është takuar të mërkurën, me kërkesë të Sirisë, për ta diskutuar vendimin e presidentit amerikan Donald Trump, për ta njohur sovranitetin e Izraelit në Rrafshnaltën Golan.

Izraeli ka pushtuar Rrafshnaltën Golan nga Siria më 1967 në një luftë në Lindje të Mesme dhe ka aneksuar këtë zonë më 1981, ndonëse Këshilli i Sigurimit i OKB-së e pati cilësuar këtë hap

"pa ndonjë efekt ligjor ndërkombëtar".

Në një letër drejtuar 15 anëtarëve të Këshillit të Sigurimit, Siria e ka përshkruar vendimin e ShBA-së si "shkelje flagrante" të rezolutës së këtij Këshilli.

Trumpi, i shoqëruar nga kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu në Uashington, ka nënshkruar të hënën një dokument, përmes të cilit i ka njohur Izraelit sovranitetin në Rrafshnaltën Golan.

Anëtarët evropianë në këtë

Këshill, Franca, Britania, Gjermania, Belgjika dhe Polonia, kanë thënë të martën se nuk njohin sovranitetin e Izraelit në këtë territor dhe kanë ngritur shqetësime rreth "pasojave të tjera" që mund të sjellë njohja e këtij aneksimi ilegal.

Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Bahrejni, Katari dhe Kuvajti, kanë kritikuar të martën vendimin amerikan, duke thënë se territori është pushtuar në tokën arabe.





BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E rrallë

Mysafiri i paftuar në fushën e golfit

Lojtarët në një fushë golfi janë befazuar pasi një aligator 3.4 metra mbërriti aty 'për t'iu bashkuar lojës'. Ed Vance dhe shokët e tij të golfit u frikësuan kur panë kafshën gjigante që doli papritmas nga një shkurre dhe nisi të ecte përmes fushës në Savannah Harbor Club në Gjeorgji. Për një moment, ata dëgjohen duke bërë titur, ndërsa zvarraniku



ecën në tokë dhe ulet aty për të marrë 'reze dielli'.

FOTO E DITES



Një familje në Mozambik shihet duke qëndruar jashtë shtëpizave pas vërshimeve të ujit. /AP/

E jashtëzakonshme

Zbulohet thesari i humbur prej një shekulli

Mijëra objekte argjendi të një familje aristokrate ruse, që u fshihën nga bolshevikët, janë ekspozuar për herë të parë në ish-kryeqytetin perandorak të Shën Petersburgut, pasi u gjetën nga disa punëtorë ndërtime. Më shumë se 2 000 objekte argjendi me vlerën e 2



milionë dollarëve u shfaqën në pallatin Tsarskoye Selo, një nga ish-rezidenat e carit që tani është kthyer në muze.

BARSOLETA E DITËS



Djali: Oj gjyshe po shumë të dua!
Gjyshja: Allahile kush të tregojë që e mora pensionin?




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

"THE KID WHO WOULD BE KING",

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

"CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

"U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award@-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Do të kaloni një ditë të hareshme dhe të qetë me disa çaste të këndshme humori. Hëna në shenjë ju bën altruist me të tjerët.



DEMI

Ndjenja e tepruar e krenarisë sot do t'ju nxjerrë antipatike në sy të miqve. Nuk do të pranoni të bëni kompromise edhe kur ta kuptoni që mund të keni gabuar.



BINJAKËT

Edhe pse mjaft nervoz, sot duhet ta gjeni ekuilibrin tuaj të brendshëm. Nuk mund të shpërtheni në çdo çast edhe kur nuk është e nevojshme.



GAFORRJA

Intuita dhe kreativiteti juaj do t'ju japin shumë favore në ambientin e punës. Do të dilni të ofroni zgjidhje shumë efektive për eprrorët tuaj.



LUANI

Sot në rrugën tuaj do të ndeshni me dikë që është mjaft i prirë t'ju ndihmojë. Keni nevojë për një person që t'ju këshillojë dhe do të ndiheni të lehtësuar.



VIRGJËRESHA

Merrni kohë për të menduar përpara se të paragjykoni të tjerët. Këto ditë nuk jeni mjaft të qetë për të pasur një vizion të qartë të gjërave.



PESHORJA

Po e çlironi fantazinë sot në gjithçka që ju bën mirë dhe është argëtuese. Do të tërhiqni në orbitën tuaj njerëz me tipare të forta egoizmi.



AKREPI

Sot ndiheni romantik dhe çdo gjë e lidhni me kujtime të bukura të marrëdhënies tuaj në çift. Do të keni një lajm nga një person që nuk e prisni.



SHIGJETARI

Sot keni shumë gjëra për të bërë dhe për të organizuar. Në rrëmujë e sipër do të harroni detaje që më vonë do t'ju prishin punë.



BRICJAPI

Në familje dhe në lidhjen në çift do të keni probleme për ta menaxhuar mbarëvajtjen e ditës. Për çdo gjest tuajin do të hasni në kundërshtime.



UJORI

Sot nuk do t'keni punët mirë me paratë. Do të shpenzoni edhe për gjëra që nuk i kishit planifikuar dhe do t'ju krijohen disa debite të njëpasnjëshme.



PESHQIT

Në një ambient të ri do t'ju marrin me sy të mirë që në ditën e parë. Mundohuni të lini të njëjtën përshtypje edhe më tutje.


Jamie Foxx shihet me ish të dashurën



Jamie Foxx është parë së fundmi duke kaluar kohë me ish të dashurën Kristin Grannis dhe vajzën e tyre Annalise. Aktori i Robin Hoodit është parë në


humor të mirë derisa po shëtiste me 42-vjeçaren Grannis dhe vajzën e tyre në Los Angeles. Foxx dhe Grannis kishin veshur të dy rroba sportive.

Justin Bieberi mbron martesën e tij pas akuzave se nuk e do gruan



Justin Bieberi është akuzuar shpeshherë se ai nuk e dashuron bashkëshorten e tij Hailey Bieber, pasi ende kishte ndjenja për Selena Gomezin. Këngëtari 25-vjeçar ka shkruar në "Instagram" duke iu përgjigjur një komenti që u bë lidhur me Selenën, që thoshte se martesja e

tij me Haileyn ishte vetëm për t'u kthyer me Selena Gomezin. Justini bëri një përgjigje të gjatë, pastaj e postoi në "Instastory", me një mesazh për fansat "stop me këto mesazhe për Hailey dhe mua, nëse më doni, merrni këto mesazhe dhe ripostoni".



Khloe Kardashian i dhuron rroba një vajze

Ylli televiziv dhe biznesmenja Khloe Kardashian i ka dhuruar rroba nga linja e saj e veshjeve "Good American" një vajze. Khloe e bëri këtë veprim pasi e pa në "Twitter" një shkrim të kësaj

vajze ku thoshte se duhet të punojë pas orarit të punës që të blejë rroba nga "Good American". Vajza Kaelyn Anber ka thënë se nuk mund ende të besoj se shkrimi i saj ka marrë shumë vëmendje.

Wendy Williams shtrihet në spital pasi gjendet e dehur



Prezantuesja televizive Wendy Williams raportohet se është gjetur e dehur në shtëpinë e saj. Sipas "People", Williamsi tani

është shtrirë në spital. Williamsi i kishte humbur lëngjet dhe pas mjekimit që mori ajo u lira për në shtëpi.



		Autor: GAZMEND MORINA	SHUFRA METALIKE TË LIDHURA SI SKELET NDËRMJET TYRE (sh.shq.)	KAFSHË E EGËR GJITARE (shq.)	SHTËPIZË ME DËRRASA (sh.shq.)	AKTORJA ISMAILI	EPOKA E RE	NDENJËSE E GJATË	ZANORE	PREMTIM SOLEMN PËR TË QËNDRUAR BESNIK (sh.shq.)	ASOCIAZIONE NAZIONALE ALOPECIA AREATA	CEREMONI FETARE	EDITA SOPJANI
		AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE JESSICA					LOKAL NATE ME PROGRAM ARTISTIK PIKË (ang.)						
		SHTET NË AFRIKË							KËNGËTARI POTOKU QYTET I MADH NË GJERMANI				
		KUKULLAT											APARTAMENT (sh.shq.)
		KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE (shqip.)										BASHKËT. RESTORANT, KAFE	
							PEABODY ESSEX MUSEUM THIKE E VOGËL XHEPI ME NJË PRESE				"LOS ANGELES" ANË E MPREHTË E NJË VEGLE		
		SHKENCA MBI MORALIN ZANORE		ZANORE IDRIZ BALAJ		KLUB BASKETBOLLI NË ITALI KUNDËRSHTARI I BOLSHEVIZMIT RUS							
		KALORËS MESJETAR						NOTË MUZIKORE	ARMË GJAHU ME NJË TYTË DHE ME FISHEKË SI TË CIFTES PORTIERI LIKA				
EPOKA E RE	FUTBOLLISTI URUGUAIAN NË FOTO (PSG)	TENISTJA SHARAPOVA	I PLOGËT	PESHA E MALLIT PA AMBALAZH	ELVIN ZAJMI	AZEM BEJTA LARTËSI QË ARRIN NJË SIPËRFAQE UJI E LIRË	SHTET NË AZI (pashq.) TERËSIA E VUJAVE QË BËHEN NË NJË ARË PËR TË UJITUR				NDESH FUTBOLLISTI GOKHAN (NAPOLI)		
	I SHQUAR, I DALLUAR						FUTBOLLISTI YNË FREDERIK MËRZEJ; RRI NË HIJE					NOTË MUZIKORE VËNIA E DATËS NË KALENDAR	
	BANORI I NJË SHTETI SKANDINAV						KËNGËTARI YNË MARKU VRULL			BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA SKAJ MAGNETIK (sh.pashq.)			TREVISO VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE
	IRNOSET (bised.)				KOMPOZITORI ITALIAN XHYZEPE					BANOR I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN KËNGËTARJA ANILA			ZYRTARIZIM I NJË MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE (sh.shq.)
	AKTORI AMERIKANE ROBERT DE				KËNGËTARJA ZAHARIA NDODHJE NË NJË VEND TJETËR NË ÇASTIN KUR ËSHTË KRYER NJË KRIM			QË LIDHET ME MONEDHËN FLETORË PËR MBAJTJEN E SHËNIMEVE DITORE					
				ALUMIN, AMPER, ZET GOJORE				DEVELOPMENT IN LITERACY BANKË QË OPERON NË KOSOVË		VARGU I PËRPUTHUR PRONË E VOGËL E SPAHINJVE OTOMAN (shq.)			
	PIKTORI VALLA ZANORE	RAMADAN (perkdh.)	OMANI, LIBERIA E TRAZOJ		VLERËSIM ME NOTË (sh.shq.) INSEKT I MËRZITSHËM (sh.shq.)						KRAHINË NË SHQIPËRI (pashq.) MËNYRË VEPRIMI (shq.)		
	NDJENJË E RESPEKTIT DHE E VLERËSIMIT TË LARTË					GJENDJA FIZIOLOGJIKE E QENIEVE TË GJALLA KËNGËTARI WEBBE (shq.)							I BUKURI (bised.) IRISH FILM INSTITUTE
	LLOJ BIME NARKOTIKE						TË BANUARIT (sh.pashq.) REVISTË QË BOTOHET NË SHQIPËRI						EMMA FAZZUOLI REGJISORJA GJONI (shq.)
	ZBËRTHIM I NJË ÇËSHTJE							SHKENCËTARI GJOTA (shq.) EMËR YNI MASHKULLI					ZANORE KUNDREJT I FORTI
	BASHKËT.	"KENIA" VIJA QË SHPIE UJIN NË MULLI			KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.) FUTBOLLISTI ABIDAL			TASH		QESËNDISËS ALBANOLOGIA DURHAM			
				E ÇMPREHE "L" NË MES TË DY "A"						JETA E QETË SHKRONJË GREKE			
	PJESA MË E LARTË E NJË MALI QË IA PRET MENDJA; I SHKATHËT					SHTEGTARE BRITMË E LOPËS							LUFTËTARI I LUFTËS SË SPANJËS VOKSHI DUKAT
	VEÇIMI						SPIKERJA HARADINAJ ZANORE				INITIATIVE GLOBUS EUROPE ZANORE		
EPOKA E RE	SHKENCËTARI NJUTON (shq.)						E NJËSUAR, E BASHKUAR					UGANDA, TANZANIA	

10 gjëra që duhet të dini para kirurgjisë kozmetike

Në vitin 2017, në Itali u kryen mbi 300,000 operacione kirurgjikale kozmetike dhe mbi 650,000 trajtime jokirurgjikale. Sipas të dhënave të mbledhura nga Shoqata Ndërkombëtare e Kirurgjisë Plastike Estetike, në majë të operacioneve të kryera është shtim i gjirit (shtim i gjoksit), e ndjekur nga liposuksioni dhe lëvizjet e qepallave.

“Kirurgjia kozmetike është një gjë serioze – kujton Daniele Fasano, president i Shoqërisë Italiane të Kirurgjisë Plastike Rindërtuese dhe Estetike: çdo gjest është “unik dhe i papërsëritshëm” dhe sapo të bëhet prerja, nuk ka kthim prapa. Është thelbësore të informoheni dhe të vendosni duke peshuar pro dhe kundër”.

Mbështetuni te një specialist dhe kontrolloni

Gjëja e parë për të kontrolluar është se mjeku është një specialist. “Duke qenë specialist në kirurgji plastike – shpjegon Daniele Fasano, president i Sicpre – do të thotë të kesh ndjekur, pas diplomimit në Mjekësi dhe Kirurgji, një kurs 5-vjeçar specializim, me shumë praktikë në sallën e operacionit. Nëse dikush nuk e konsideron kirurgjinë e kataraktit nga dikush që nuk është okulist, pse duhet të mbështeteni në kirurgji kozmetike për ata që nuk janë kirurgë plastike? Kujdes pastaj për faktin se nuk ka kirurgë plastike dhe kirurgë kozmetikë: specialiteti është vetëm një. Si të kontrolloni nëse mjeku është specialist?”

Struktura? Varet nga ndërhyrja

Disa trajtime mund të kryhen në studio dhe në klinikë (ky është rasti me mbushës dhe Botox); të tjerët kanë nevojë për sterilitetin e sallës së operacionit; të tjerët – që duhet të kryhen në siguri të plotë – kanë nevojë për garanci shtesë, siç është prania e vazhdueshme e anesteziologëve të rikonstruksionit. Parimi themelor – thotë Corrado Rubino, drejtor i Shkollës së Specializimit në Shkencat Mjekësore Kirurgjikale dhe Eksperimentale në Universitetin e Sassari – është ai i një mjedisi operativ dhe organizativ që lejon përballimin më të mirë të rasteve negative, sado të rralla. Kujdes atëherë të zgjidhni gjithmonë strukturat e njohura që janë të akredituara nga Rajoni në të cilin ata janë të vendosur”.

Vizita e parë: më e rëndësishme se takimi i parë

Midis doktorit dhe pacientit



duhet të ketë besim dhe njohje, pak a shumë si në një histori dashurie. “Marrëdhënia e besimit është thelbësore – thekson Massimo Navissano, këshilltar i Sicpre. – Pacienti duhet ta dokumentojë veten, natyrisht, por nuk mund t’i besohet vlerësimit të rastit dhe identifikimit të rrugës terapeutike. Për këtë arsye është thelbësore që të krijohet një aleancë midis mjekut dhe pacientit në emër të ndjeshmërisë dhe kompetencës. Besimi i kirurgut tuaj plastik do të thotë të bindesh për shëndetin e zgjedhjes suaj në aspektin e materialeve dhe strukturave. Rruga ideale fillon nga ekspozimi i kërkesave të pacientit dhe kirurgu propozon një trajtim ose më shumë se një, kur është e mundur”.

Në rastin e implanteve të gjirit, duhet të merrni shpjegim

Shtimi i gjirit është një nga operacionet plastike më të kryera në botë. Dhe protezat e përdorura për të arritur qëllimin janë pajisje të sigurta dhe të kontrolluara. “Është thelbësore që kirurgu t’i shpjegojë gruas karakteristikat e protezave të zgjedhura – shpjegon Fasano. – Dhe është mirë që pacienti gjithmonë t’i kërkojë kirurgut për etiketën e protezës, me treguesin e llojit, numrit serik dhe prodhuesit. Është e rëndësishme të dini se çfarë keni veshur”. Në përputhje me indikacionet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të kompanive kryesore të kirurgjisë plastike në botë, Sicpre fton gratë që të ndjekin kontrollat periodike të dakorduara, pa nevojë për kontrolle të mëtejshme, nëse nuk tregohet nga kirurgu.

Protezat, ka edhe sigurime

Një nga protezat më të fundit është sigurimi i ofruar nga disa prej prodhuesve kryesorë. “Ajo është e lidhur me këputje dhe kontrakturë kapsulare, një efekt i padëshiruar që ndodh në 3-4 për qind të rasteve, – tregon Navissano. – Kontraktimi është mënyra në të cilën organizmi përfundon rreth trupit të huaj që janë proteza, duke i mbuluar ato me një ind fibroz që ndonjëherë ndryshon formën e gjirit, duke kompromentuar rezultatin estetik. Ata që kanë zgjedhur “proteza të siguruar” në rastin e këtyre ngjarjeve negative do të jenë në gjendje të llogarisin në pjesëmarrjen e prodhuesit në kostot e nevojshme për zëvendësimin”.

Filler, kur duhet të besohet

Acidi Hyaluronic është fillerja kryesore, substancat e përdorura në luftën kundër plakjes për të zbutur brazdat dhe për të rritur përkohësisht (nga 6 në 18 muaj, në varësi të formulimeve) vëllimin e kockave të faqes dhe buzëve. “Infiltrimi i mbushësit sigurisht që është një akt minimalisht invaziv, por është përfundimi i një vlerësimi mjekësor, i cili nuk duhet të lihet në duart e përgatitura keq, – kujton Rubino. Vëmendje pastaj ndaj produkteve: pacienti duhet të pyesë se çfarë do të injektohet dhe nëse produkti është i pajisur me shenjën CE, e cila vërteton përputhjen me kërkesat thelbësore të kërkua nga direktivat e Bashkimit Europian”. Këshilla të tjera: gjithmonë preferoni produkte absorbuese, janë të tolerueshëm.

Botoksi, pro dhe kundër

Me më shumë se 5 milionë infiltrime në botë në vitin 2017 (të dhënat ISAPS), Botox është trajtimi më i mirë mjekësor estetik në botë. Në shumicën dërrmuese të rasteve përdoret për të zbutur rrudhat e ballit dhe ato përreth syve, përkohësisht duke mbështetur muskujt që përndryshe, me moshën, gjithmonë mbeten pak të shtrënguar, duke i dhënë fytyrës një shprehje të lodhur dhe të mërziut. “Por ne nuk duhet të ekzagjerojmë, – thekson Fasano. – Deri në një shkallë të caktuar të plakjes, mbushësit dhe Botox japin rezultate natyrale dhe të këndshme. Në vend të kësaj, kur indet janë patjetër në rënie, mënyra më e mirë është t’i ripoziciononi ato në mënyrë kirurgjikale, për shembull me një ndërhyrje sektoriale. Prandaj, është thelbësore të konsultoheni me një specialist të mirë.

Pëlqim gjithmonë i informuar

Para se të merret me ndonjë operacion kirurgjik (duke përfshirë operacionet estetike), pacienti duhet të nënshkruajë gjithmonë një formular, të ashtuquajturën pëlqimin e informuar, i cili përmbledh karakteristikat e operacionit, eventualitetet e mundshme negative që mund të lindin. “Është dokumenti që vërteton, të zezë mbi të bardhë, se si pacienti është ekspozuar gjithashtu ndaj rreziqeve të mundshme dhe nevojës së mundshme për t’u bërë prekur, për shembull për të përmirësuar cilësinë e plagëve, – thotë Navissano. Kirurgjia kozmetike e ekzekutuar mirë

është në përgjithësi e sigurt, por pacienti duhet të informohet për gjithçka”. Jini të kujdesshëm ndaj ekspozimeve të shpejta dhe të thjeshta.

Çmime të qarta dhe pa zbritje

Një nga elementet për t’i kushtuar vëmendje para se të bëhet kirurgji kozmetike është çmimi. Dhe specialistët theksojnë: jo në zbritje, (nuk ka depot për të zbrazur) dhe absolutisht jo nën kosto. Tarifa e kirurgut është një artikull i vazhdueshëm, i njëjtë me koston e klinikës dhe të materialeve, – thotë Fasano. – Pra, ata që ofrojnë “zbritje” janë thjesht duke u përpjekur për të tërhequr pacientët me mjete të pasakta”. As në vizitën e parë pa asnjë kosto, sikur çdo vizitë duhet të çojë gjithmonë në trajtim ose ndërhyrje.

Lehtësim, më mirë ta marrësh në konsideratë më parë

Përveç infiltrimit të mbushësit dhe Botox (ku mund të ndodhin skuqje të vogla dhe bruising) të gjithë pjesa tjetër përfshin një rikuperim. “Në disa raste, për shembull në ndërhyrje të mëdha si abdominoplastia ose mastoplastia reduktuese, mbijetesat duhet të kuptohet si një periudhë pushimi, – thotë Rubino. Për korrigjime më pak invazive, të tilla si korrigjimi i qepallës, është ende një periudhë në të cilën ende ekzistojnë ënjtje dhe qepje. Është një aspekt i rëndësishëm që duhet marrë parasysh për të planifikuar angazhimet personale dhe profesionale në përputhje me rrethanat”.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Prishtina rikthehet në vendin e dytë

FC Prishtina ia ka arritur ta fitojë ndeshjen e tretë ndaj Flamurtarit në këtë kampionat, pasi një përballje e kishte humbur dhe një herë kishte luajtur baras. Tri pikët e fituara e kanë rikthyer skuadrën kryeqytetase në vendin e dytë e tash është vetëm pesë pikë pas Feronikelit, kurse Flamurtari është në vendin e nëntë me 28 pikë



EPOKA E ENJTE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 27 MARS - Prishtina është rikthyer në pozitën e dytë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pasi e ka mposhtur Flamurtarin me rezultat 3-0. Ndeshja e mbetur e javës së 23-të u zhvillua të mërkurën në stadiumin "Fadil Vokrri", kurse Prishtina me këtë rast i është "hakmarrë" skuadrës tjetër nga kryeqyteti, Flamurtarit, për humbjen në ndeshjen e kaluar në elitë. "Kemi bërë paraqitje të bukur. E realizuam shpejt golin e parë, kurse goli i dytë na dha më shumë siguri. Flamurtari ishte skuadër që në zonën tonë nuk krijoi raste", ka thënë pas ndeshjes Mirel Josa, trajner i Prishtinës.

"Bardhekaltrit" e nisën mirë ndeshjen duke rrezikuar pas shtatë minutave lojë. Korenica pati në rast të mirë shënimi, por gjuajtjen e tij e ndali portieri Flamur Neziri. Në minutën e 12-të Krasniqi i Flamurtarit provoi nga gjuajtja e lirë, por Bekaj e dëboi topin mbi portë. Një minutë më vonë Ergyn Ahmeti provoi nga distanca, por gjuajtja e tij përfundoi jashtë portës së Nezirit. Në minutën e 16 Mankenda bëri një depërtim fantastik, duke e shfrytëzuar edhe rrëshqitjen e mbrojtësit Quansah, më pas asistoi deri te Korenica që nuk e pati të vështirë të shënojë për 1-0. Prishtina mori zemër nga ky gol i shënuar dhe pas gjashtë minutave dyfishoi rezultatit nëpërmjet Marjo Morinës. Morina në minutën e 23-të pati edhe një rast tjetër, por Neziri ishte në vend. Flamurtari më pas

Stadiumi "Fadil Vokrri"

Shënues: Korenica (16', 56') dhe Morina (22')

Shikues: Mbi 500

Gjyqtarë: Mervan Bejtullahu, Erduan, Baliqi, Gëzim Mehmeti, Ilir Mehmeti

Karton të verdhë: Miftaraj, Thaqi (Prishtina), Quansah (Flamurtari)

Prishtina: Bekaj, Thaqi, Bekteshi, Haliti, Bashiru, Miftaraj, Arango (Mustafa), Ahmeti (Boshnjaku), Korenica (Hoxha), Mankenda, Morina.

Flamurtari: Neziri, Dragusha, Quansah, Grančov, Rexhaj, Bruqi, Zeqiri (Ibrahim), Boshnjaku (Adamau), Maliqi, Krasniqi, Shillova.

u mundua të rikthehet, por gjuajtja e Alban Shillovës përfundoi në duart e portierit Bekaj. Korenica rrezikoi edhe

dy herë të tjera, fillimisht nga gjuajtja e lirë e më pas edhe me kokë, por rezultati mbeti 2-0 në pjesën e parë. Në minutën e 56 Mankenda bëri edhe një tjetër depërtim dhe më pas asistoi për Korenicën, i cili nga afërsia realizoi golin e dytë personal dhe të tretin për skuadrën e Prishtinës. Deri në fund të ndeshjes të dyja skuadrat patën edhe nga dy raste shënimi, por rezultati mbeti 3-0.

Pas përfundimit të ndeshjes, Arsim Thaqi pranoi se Prishtina është skuadër më e mirë se Flamurtari. "Kishim mungesa si Lorik Maxhuni dhe Gëntit Dumani, të cilat nuk i kompensuam. Aty ku e dinim se do të kemi vështirësi, Prishtina na goditi. Prishtina është ekip me cilësi më të mira sesa Flamurtari dhe tani jemi edhe ne në presion. Edhe pushimi prej gati tri javësh bëri që Flamurtari të mos jetë ai që jemi mësuar ta shohim", ka deklaruar Thaqi.

Skuadra e Mirel Josës pas kësaj fitore rikthehet në pozitën e dytë me 50 pikë, pesë pikë më pak se Feronikeli që është në vend të parë, kurse Flamurtari pozicionohet në vendin e nëntë me 28 pikë.

IPKO SUPERLIGA

Në xhiron e 24-t takohen:

KEK-u - Drenica

Gjilani - Trepça '89

Liria - Llapi

Flamurtari - Feronikeli

Ballkani - Prishtina

Ferizaj - Drita

TABELA

1. Feronikeli	23	55 pikë
2. Prishtina	23	50
3. Llapi	23	48
4. Drita	23	38
5. Gjilani	23	32
6. Drenica	23	30
7. Ballkani	23	29
8. Trepça '89	23	28
9. Flamurtari	23	28
10. Ferizaj	23	25
11. Liria	23	24
12. KEK-u	23	1

SHKURT

FFK-ja: Sot mbahet Kuvendi i Punës

Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se sot (e enjte) do ta mbajë Kuvendin e Rregullt të Punës. Kuvendi do të mbahet në hotel "Emerald" nga ora 17:00, ku do të bëhet prezantimi i punës në periudhën 2018/2019.

Hamiti largohet nga Ferizaj

Futbollisti i njohur në futbollin e Kosovës, Genc Hamiti, është larguar nga skuadra e Ferizajt. Ai nuk ka qenë pjesë në përgatitjet që i zhvilloi ditë më parë në Shqipëri, kurse shkak për këtë ndarje është bërë mosmarrëveshja me trajnerin Bylbyl Sokoli. Hamiti deri në verë do të mbetet lojtar i lirë, kurse në të kaluarën ka luajtur për Hajvalinë, Prishtinën dhe Drenicën.

Petkoviqi: Xhaka kërkoi zëvendësimin, ishte i lënduar

Zvicra nuk ka arritur të triumfojë para shikuesve të vet në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian "Euro 2020", edhe përkundër faktit se kishte epërsinë prej tri golave. Trajneri i Zvicrës, Vladimir Petkoviq, foli për kritikën e shumta që mori në lidhje me zëvendësimin e Granit Xhakës, duke thënë se futbollisti i Arsenalit ishte i lënduar. "Graniti nuk mund të vazhdonte në fushë, sepse ishte duke vuajtur nga një lëndim. Ai kërkoi zëvendësimin dhjetë minuta më herët", ka deklaruar Petkoviq.

Hernandezi, transferimi më i shtrenjtë në histori të Bayernit

Tash edhe zyrtarisht Lucas Hernandez është lojtar i ri i Bayern Munchenit. Kontrata pesëvjeçare për lojtarin francez fillon nga 1 korriku, kurse kostoja e transferimit është 80 milionë euro. Mbrojtësi që është pjesë e Atletico Madridit deri në fund të këtij edicioni do të bëhet transferimi më i shtrenjtë në histori të klubit gjerman dhe të Bundesligës.

Kante: Nuk më intereson interesimi i Realit

N'golo Kante nuk është i interesuar të largohet nga Chelsea, ani pse për të ka shfaqur interesim Real Madridi. "Për momentin jam te Chelsea dhe çfarë thuhet në krahun tjetër nuk ka shumë rëndësi. Edhe në rast se më telefonon Zidane nuk ka rëndësi. Jam lojtar i Chelseas dhe jam i fokusuar te kjo skuadër", ka deklaruar Kante.

FShF-ja kontakton Safet Susiqin

TIRANË, 27 MARS - Federata Shqiptare e Futbollit e ka kontaktuar boshnjakun Safet Susiq për trajner të ri të kombëtares kuqezi. 63-vjeçari, i cili ka qenë pushim për disa muaj që prej largimit nga stoli i skuadrës

turke Akhisar, ka lënë mundësinë e hapur për të qenë pasardhës i Christian Panuccit. "Nuk ka asgjë konkrete. Kam një shok në Paris që është këshilltar futbollit dhe krahu i djathtë i presidentit të FShF-së me të cilin takohem

shpesh. Por, nuk ka asgjë për t'u thënë për momentin. Jam gati të bisedoj, pasi aktualisht jam një trajner i lirë, por vetëm nëse ka diçka serioze", ka thënë Susiq. Trajneri veteran e ka drejtuar më parë, për pesë vjet me radhë,

kombëtaren boshnjake, kurse ka qenë në bankinë në kualifikueset e Evropianit 2012, në barazimin 1-1 në stadiumin "Qemal Stafa", si dhe kur Bosnja fitoi 2-0 ndaj Shqipërisë në qershor të vitit 2011 në shtëpi.



Karateistët synojnë medalje në Guadalajara të Spanjës



PRISHTINË, 27 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës prej 28 deri më 31 mars do ta marrë pjesë në kampionatin e 54-t evropian për seniorë, i cili do të mbahet në qytetin e Guadalajaras së Spanjës. Gjithsej 10 karateistë do ta përfaqësojnë Kosovën në shtetin i cili vazhdon të mos e njohë Kosovën, njëkohësisht duke iu nxjerr shpesh herë edhe probleme sportistëve.

Vlerona Shala (kata), Albulena Gërvalla (-55 kg), Fortesa Orana (+68 kg), Argjend Berjani (kata), Orges Arifi (-60 kg), Ylli Cenaj (-67 kg), Elhami Shabani (-75 kg), Alvin Karaqi (-84 kg), Herolind

Nishevci (+84 kg), do të kërkojnë medalje, ndërsa në kumite Kosova përfaqësohet me Nishevcin, Arifin, Cenajn, Karaqin, Shabanin, si dhe Blodin Pakashitcën.

Albulena Gërvalla vjen pas suksesit në evropianin U-21 të mbajtur muajin e kaluar në Aalborg të Danimarkës, ku fitoi medaljen e bronzit, ndërsa Herolind Nishevci rikthehet në gara pas mungesës në Karate 1 Series A Salzburg 2019, ku në vitin e kaluar kishte fituar medaljen e artë. "Jemi përgatitur maksimalisht për pjesëmarrje në këto gara shumë të rëndësishme dhe

shpresoj se në Kosovë do të kthehem si fitues me medalje. Atje do të shkojmë me dhjetë garues, tri femra dhe shtatë meshkuj", ka thënë Ismet Krasniqi, kryetar i Federatës së Karatesë së Kosovës. Në evropianin e kaluar të mbajtur në Novi Sad të Serbisë, Kosovës iu mohua hyrja për në Serbi nga qeveria e këtij vendi. Evropiani i tashëm është rast i mirë për të fituar pikë olimpikë për Lojërat Olimpikë "Tokio 2020", si dhe për ta fituar normën për Lojërat Evropiane "Minsk 2019", të cilat mbahen prej 21-30 qershorit 2019 në Minsk të Bjellorusisë.

Lakersat fitojnë, por i thonë lamtumirë 'play-off'-it

LOS ANGELES, 27 MARS - U luajtën ndeshjet e radhës në NBA. Më konkretisht, liga më e fortë e basketbollit në botë dhuroi spektakël në të gjitha ndeshjet. Më konkretisht, Los Angeles Lakersi mori një fitore në parket, por nuk i bën punë, sepse janë shuar edhe shanset matematikore për të shkuar në fazën e "play-off"-it. Rezultati 124-106 ishte një gëzim për tifozët vendës, të cilët panë të thyhej Washington Wizardsi në "Staples Center". Basketbollisti



më produktiv i vendësve ishte Kentavious Caldwell-Pope, që shënoi 29 pikë. Gjashtë pikë më pak se ai regjistroi në këtë ndeshje LeBron Jamesi. Për miqtë spikati Bradley Beal, me 32 pikë, i ndjekur nga Jabari Parker, me 18 pikë. Në këtë moment të kampionatit, Los Angeles zë vendin e 11 të Konferencës Perëndimore.

REZULTATET

Los Angeles L. - Washington W.	124-106
Charlotte - San Antonio	125-116
Cleveland - Boston	106-116
Miami - Orlando	99-104
Toronto - Chicago	112-103
Milwaukee - Houston	108-94
Minnesota - L.A. Clippers	111-122
New Orleans - Atlanta	120-130
Dallas - Sacramento	121-125
Denver - Detroit	95-92

SHKURT

Herrera pëlqen kalimin në Arsenal

Ander Herrera ka zgjedhur Arsenalin. Sipas medieve angleze, mesfushori spanjoll ka vendosur të mos rinovojë kontratën që i skadon më 30 qershor me Manchester Unitedin, pasi dëshiron të transferohet në Londër. Një lajm vërtet i hidhur ky për trajnerin e Unitedit, norvegjezin Ole Gunnar Solskjaer, i cili e konsideron një lojtar shumë të rëndësishëm Herreran dhe që nga mbërritja e tij në "Old Trafford" e ka aktivizuar rregullisht.

Reali ofron Krossin për Pjaniqin

Për momentin është thjesht një ide, por shkëmbimi mes Toni Krossit dhe Miralem Pjaniqit është një nga mundësitë e kësaj vere. Zërat nga Spanja shprehen se mesfushori boshnjak i Juventusit është sërish nën radarët e presidentit Florentino Perez, pasi e provoi edhe verën e kaluar. Gjithashtu, Pjaniqi pëlqehet edhe nga trajneri Zidane. Dhe për të arritur te ky shkëmbim, po mendohet që në Torino të ofrohet gjermani Toni Kross. Për momentin Juventusit është frenuar prej trogës: Pjaniqi fiton 6.5 milionë euro në vit, ndërsa Krossi pothuajse dyfishin. Gjithsesi, "Tuttosport" raporton se drejtori Fabio Paratiçi mund të bënte një sforcë ekonomike, pasi ta vlerësojë edhe anën teknike të këtij operacioni.

Hummelsi nuk i kursen kritikak për trajnerin Low

Para se të luheshin ndeshjet kundër Serbisë dhe Holandës, trajneri i Gjermanisë, Joachim Low, zyrtarizoi një vendim të guximshëm në lidhje të "Mannschaft". Ai vendosi t'i largojë nga kombëtarja tre senatorë, kampionë bote, si Jerome Boateng, Thomas Muller dhe Mats Hummels. Ky i fundit, duke folur për "Bild", nuk e ka kursyer "helmin" në drejtim të trajnerit: "Ndoshta unë bëj gjëra që nuk i pëlqejnë të tjerët. Pra, nuk jam i zemëruar, edhe pse disa njerëz marrin vendime që kanë efekt negativ mbi mua".

Barça interesohet për Rashfordin

Barcelona është hedhur në kërkim të sulmuesit anglez Marcus Rashford. Katalanasit janë hedhur në sulm për lojtarin anglez i cili ka shkëlqyer këtë sezon me Manchester Unitedin. "Mirror" njofton se për kryerjen e këtij operacioni, Barcelona ka ofruar 100 milionë paundë. Anglezi është pjesë e "Djajve të Kuq" që nga viti 2005, por ende nuk ka nënshkruar rinovim me klubin, që ka çuar deri te interesimi i gjigantit katalanas. Rashfordi konsiderohet një prej emrave më të kërkuar brenda skuadrës së Manchester Unitedit.

Balotelli, Mançinit: Në të ardhmen mund ta refuzoj Italinë

Mario Balotelli po luan dhe po shënon rregullisht që nga transferimi i tij te Olympique Marseille por, pavarësisht prej këtij fakti, Roberto Mançini, njeriu që i dha mundësinë e debutimit tek Interi që në moshën 17-vjeçare, nuk e grumbulloi për dy sfidat e para kualifikuese ndaj Finlandës dhe Lihtenshtejnit. "Një ditë mund të keni nevojë për mua dhe unë do të jem gati, ashtu siç kam qenë edhe gjatë këtyre tre vjetëve të fundit, por më keni nënvlerësuar. Unë nuk jam një robot, një epidemi apo një budalla. Shpesh nuk përgjigjem për të evituar polemika dhe tensione të kota. Gjithçka e grumbulloj brenda meje, por një ditë mund të shpërthej edhe unë kundër të gjithëve", ka thënë Balotelli. "Ju lutem, më respektoni aq sa edhe unë e respektoj Italinë dhe më pas do të jemi të gjithë së bashku në të njëjtën linjë dhe jo kundër. Nuk pretendoj të më përkëdhelni, apo të më konsideroni një fenomen. Nëse më respektoni ju garantoj se do të merrni më të mirën nga unë. Nuk po bëj asgjë të keqe për të mos më respektuar. Ndaj dua të ndihem si gjithë të tjerët", u shpreh Balotelli.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada – Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Univerziteteske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
 University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Në bazë të nenit 8 pika 1 dhe 2 e të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik; Neni 6 paragraf 1.1, neni 10 paragrafi 1, neni 13 paragrafi 1 dhe 3, të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK); Neni 62 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125; Neni 10 paragrafi 1.1.1, dhe neni 13 pika 1 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës; Neni 5, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003/2016; dhe Kërkesës nr. 357 të datës 08.03.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së publikon:

KONKURS

Institucioni: Qendra Klinike Universitare e Kosovës
 Sektori: Sektori i Personelit të QKUK-së,
 Norma e punës: Orari i plotë,
 Kontrata: Sipas legjislationit në fuqi
 Titulli i vendit të punës: Zyrtar në Sektorin e Personelit (për Rekrutim dhe Selektim) në QKUK (1 pozitë)
 I Raporton: Shefit të Sektorit të Personelit në QKUK,
 Kategoria funksionale/Grada: 7.2.
 Nr. i Referencës: QKUK- 10/2019-03/1

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i Personelit - procedurat e rekrutimit, avancimeve, lëvizshmërisë dhe transfereve

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Përgatitja e konkursit sipas kërkesave të Klinikave, Instituteve dhe Shërbimeve në kuadër të QKUK-së dhe Njësitë tjera përbërëse organizative të SHSKUK-së, e të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së dhe Bordi Drejtues i SHSKUK-së; dorëzimi për nënshkrim tek Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, protokollimi në Arkivën Qendrore të QKUK-së, dhe shpallja në mjetet e informimit,
- Përgatitja e aplikacioneve për pjesëmarrësit në konkurs, protokollimi i tyre në protokollin e brendshëm, pajisja e kandidatit me numrin e protokollit dhe numrin e faqeve të bashkangjitura (si dëshmi për dorëzimin), dhe regjistrimi i të dhënave të aplikantit në listën e krijuar për të gjithë aplikantët konkures,
- Renditja e aplikacioneve sipas pozitave të Konkursit në kuadër të Klinikave Instituteve apo Shërbimeve,
- Njoftimi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së rreth numrit të pjesëmarrësve në konkurs, pas kalimit të afatit ligjor të konkursit, nëpërmjet Shefit të Sektorit të Personelit,
- Përgatitja e Vendimeve për formimin e komisioneve intervistuese sipas bazës ligjore në fuqi
- Caktimi i vendit, datës dhe orës për intervistim, në bashkëpunim me Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit përzgjedhës
- Ftesa kandidatëve të rrethit të ngusht për intervistim si dhe përfaqësuesit të Sindikatës,
- Përgatitja e formularëve për intervistim të nënshkruara nga secili anëtar i komisionit, renditjen përfundimtare të pikëve dhe shpallja e kandidatit fitues protokollohet në Arkivën Qendrore dhe publikohet në tabelën e shpalljeve,
- Kompletimi i dosjes së konkursit dhe i ruajtja sipas bazës ligjore në fuqi,
- Përgatitja e Vendimeve për themelimin e marrëdhënies së punës dhe dorëzimi tek zyrtari i dosjeve personale së bashku me aplikacionin dhe vlersimet individuale.
- Përgatitja e Vendimeve për avansime, transfere, sistemeve etj, sipas kërkesës të aprovuar e të nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, të cilat protokollohen dhe dorëzohen me nënshkrim tek zyrtari i dosjeve për përpilimin e kontratës dhe futjes në dosje personale,
- Regjistrimi i të gjitha Vendimeve në programin elektronik dhe me nënshkrim dorëzimi në dosje personale,
- Përgatitja edhe shkresave tjera të cilat kërkohen nga përgjegjësit dhe bashkëpunimi i ngusht me ta lidhur me zbatimin e legjislationit në fuqi,
- Protokollimi i të gjitha shkresave, përfshirë njoftimet, Vendimet, konkurset e të tjera, në protokollin e zyrës,
- Përgatitja e kopjeve të dokumentacioneve që kërkohen nga Inspektoriati i punës dhe mbajtja e evidencës lidhur me dokumentet e ofruara.
- Kryen edhe detyra të tjera – në përputhje me ligjet dhe rregulloret momentale – të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Përgatitja shkollore Fakulteti Juridik - Jurist i diplomuar;
- Dy vjet përvojë pune, të ndërlidhura me lëmin e kësaj detyre.
- Njohuri të gjuhës shqipe, duke përfshirë edhe aftësi të zhvilluara për hartimin e shkresave.
- Certifikatën e lindjes,
- Letërnjoftimi, fotokopje.

Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet.

Origjinalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuara të noteri do të kërkohet vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, sipas konkursit në fjalë.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar për këtë pozitë.

Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e shpalljes në një nga mjetet e shkruara elektronike.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Sektorit të Personelit në QKUK (objekti i ri i administratës). Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Kontaktet me telefon mund t'i bëni në 038/512-667

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbyljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë të ofrojnë dëshmi sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Çdo kandidat që aplikon dhe i plotëson kushtet sipas konkursit do t'i nënshkruhet testit me shkrim prej 100 poenëve. Kandidatët të cilët kalojnë 50 % të testit, fitojnë të drejtën të thirrjen për intervistim me gojë.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada – Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Univerziteteske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
 University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Prema članu 8 Zakona, tačka 1 i 2 Zakon o radu br. 03/L-212; Administrativno Uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru; Člana 6. tačka 1 i 1, član 10 tačka 1, član 13 tačka 1 i 3 Statuta Bolničke Službe i Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK); Član 62, Zakona br. 04/L-125, o Zdravstvo; Član 10 tačka 1.1.1, član 13, tačka 1, Statuta Univerzitetski Klinicki Centar Kosova; Član 5, tačka 1 i 2. Uredbe o Radnim Odnosima br. 1003 datum 21.07.2016; i Zahteve br. 357, dana 08.03.2019, Generalni Direktor UBKSK, objavljuje

KONKURS

Institucija: Univerzitetski Klinički Centar Kosova
 Sektor: Kadrovski Sektor u UKCK,
 Radna stopa: Puni raspored,
 Ugovor: P
 Naziv posla: Službenik u Kadrovskom Sektoru za Zapošljavanje i Selekciju u UKCK (1 pozicija)
 Raportuje kod: Šef Sektora za Kadrovc u UKCK,
 Funkcionalna kategorija / Grad: 7.2.
 Br. Referenca: UKCK - 10/2019-03/1

Naziv posla: Službenik u Kadrovskom Sektora, zapošljavanje, promociju, mobilnost i procedure transfere.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Priprema konkursa prema zahtevima Klinika, Instituta i Službi u okviru UKCK-a i drugih organizacionih jedinica UBKSK, odobrenih od strane Generalnog Direktora UBKSK-a i Upravnog Odbora UBKSK-a; Generalnom Direktoru UBKSK-a, protokolima u Centralnom Arhivu UKCK-a, i saopštenju u medijima,
- Priprema aplikacije za Konkursa, njihove protokole u internim protokolima, oprema kandidata sa brojem protokola i brojem priloženih stranica (kao dokaz o podnošenju), i registracija podataka o podnosiocu zahteva na listi koja je napravljena za njega svim konkurentnim kandidatima,
- Rangiranje aplikacije prema pozicijama konkursa u okviru kliničkih instituta ili službi,
- Obaveštenje Generalnog direktora UBKSK-a o broju učesnika na konkursa, nakon isteka zakonskog roka konkursa, preko rukovodioca kadrovskog sektora,
- Priprema Osnovom, članovima selekcion komisije
- Pozvati anketare u uskom krugu i predstavnike sindikata,
- Priprema obrazaca za intervju potpisan od strane svakog člana komisije, konačnog rangiranja bodova i objavljivanja pobjedničkog kandidata su protokoli Centralnom arhivu i objavljeni u oglasnoj tabli,
- Dovršanje konkursnog dosijea i održavanje prema pravnoj osnovi na snazi,
- Priprema Odluka za uspostavljanje radnog odnosa i podnošenje službenika za lične dokumente zajedno sa aplikacijom i pojedinačnim procjenama.
- Priprema Odluka za napredovanje, prenos, poravnanje, itd., Na zahtev odobren i potpisan od strane Generalnog Direktora UBKSK-a, koji se protokolira i podnose sa potpisom službeniku za sastavljanje ugovora i unošenje u personalnoj dosije,
- Registracija svih Odluka u elektronskom programu i potpisivanje podneska u personalnoj dosije,
- Priprema drugih dokumenata potrebnih za odgovornu i blisku saradnju sa njima u vezi sa sprovođenjem zakonodavstva na snazi,
- Dokaz svih dokumenata, uključujući obaveštenja, odluke, druga slobodna radna mesta, u protokolu kancelarije,
- Priprema kopija dokumentacije potrebne za inspekciju rada i vođenje evidencije o dostavljenim dokumentima.
- Obavlja druge zadatke - u skladu sa važećim zakonima i propisima - koji se s vremena na vreme mogu razumno tražiti

Potrebna kvalifikacija i iskustvo:

- Pripremiti Pravni Fakultet - Diplomirani Pravnik;
- Dve godinu dana radnog iskustva vezanog za oblast ovog zadatka.
- Poznavanje albanskog jezika, uključujući razvijene vještine za pisanje radova.
- Izvod iz matične knjige rođenih,
- Lična karta, fotokopija.

Dokumentacija priložena ovoj aplikaciji se ne vraća.

Original ovih dokumenata ili atestiranih notara će biti potreban samo kada se kandidat pozove na posao.

Uslovi učešća u zapošljavanju: Pravo prijave su svi državljani Republike Kosova odraslih koji imaju potpunu poslovnu sposobnost, u skladu sa konkursu u pitanju.

Procedura konkurencije: Konkurs je otvoren za sve kandidate zainteresirane za ovu poziciju.

Konkurs se objavljuje 15 dana od dana objavljivanja na jednom od elektronskih sredstava.

Podnošenje zahteva: Zahtev se primaju i dostavljaju u kancelariju UKCK - Kadrovske službe (Novog administrativnog objekta UKCK).

Aplikacija treba jasno navesti naziv posla i referentni broj. Telefonski kontakti se mogu izvršiti na 038/512-667

Zahtevi koje su poslate nakon završetka konkursa i nepotpune zahteve neće biti prihvaćene.

Podnosioci zahteva pruži dokaze od strane konkursa za različite kandidate koji ne ispunjavaju uslove konkursa neće biti pozvan na razgovor.

Svaki kandidat koji se prijavljuje i ispunjava uslove konkursa podleže pismenom testu od 100 bodova. Kandidati koji polože 50% testa, stiču pravo da budu pozvani na usmeni razgovor.

Generalnog Direktora UBKSK

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Spektori i Personelit



Në bazë të nenit 8 pika 1 dhe 2 e të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik; Neni 6 paragrafi 1.1, neni 10 paragrafi 1, neni 13 paragrafi 1 dhe 3, të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK); Neni 62 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125; Neni 10 paragrafi 1.1.6, dhe neni 13 pika 1 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës; Neni 5, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003/2016; dhe Vendimit nr. 181/5 datë 19.03.2019, Drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së publikon:

KONKURS

Institucioni:	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
Departamenti:	Spektori i Mirëmbajtjes së Pajisjeve Mjekësore, QKUK-së,
Norma e punës:	Orari i plotë,
Kontrata:	Sipas legjislacionit në fuqi
Tiulli i vendit të punës:	Zyrtar i Lart i Mirëmbajtjes së Pajisjeve Mjekësore (1 pozitë)
I Raporton:	Shefit të Sektorit të Mirëmbajtjes së Pajisjeve Mjekësore,
Kategoria funksionale/Grada	8.4.
Nr. i Referencës:	QKUK- 12/2019-03/1

Zyrtar i Lartë i Mirëmbajtjes së Pajisjeve Mjekësore

Nën udhëqjen e Udhëqësit të Sektorit të mirëmbajtjes së Pajisjeve, Zyrtari i lartë i Mirëmbajtjes për pajisje mjekësore ndihmon drejtorët e klinikave dhe menaxhmentin e QKUK në të gjitha çështjet e pajisjeve mjekësore të nevojshme për punë.

Përgjegjësitë kryesore:

- Këshillojnë drejtorët e klinikave të QKUK në definimin e pajisjeve të nevojshme për punë
- Ndihmon menaxhmentin e QKUK në priorizimin e pajisjeve të nevojshme për punë
- Këshillojnë sektorin e mirëmbajtjes së pajisjeve lidhur me manualët dhe kushtet e mirëmbajtjes së pajisjeve
- Përpilon specifikimet teknike për pajisjet mjekësore të cilat parashihen të prokurohen
- Regjistron pajisjet mjekësore në të gjitha njësitë punuese të QKUK-së.
- Kompletimi i dokumentacionit teknik të pajisjeve
- Hartimi i doracakëve të përshtatshëm për aftësimin dhe përdorimin e pajisjeve nga ana e teknikëve mbi rolin dhe principin e punës
- Mbajtja e trajnimeve periodike me qëllim të ngritjes profesionale të teknikëve të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore në kuadër të QKUK/SHSKUK;
- Kryerjen e detyrave shtesë sipas kërkesës së Udhëqësit të sektorit.

Kualifikimi dhe përvoja e kërkuar:

- Fakulteti i inxhinierisë mekanike ose elektronike,
- Shkollim adekuat në fushën e pajisjeve mjekësore,
- Përvojë pune në fushën e pajisjeve mjekësore së paku 3 vjet,
- Shkathësi kompjuterike në fushën e pajisjeve kompjuterike,
- Shkathësi organizimi dhe komunikimi në të shkruar dhe në të folur,
- Njohja e gjuhës angleze,
- Certifikatën e lindjes,
- Letërnjoftimi, fotokopje.

Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet.

Originalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuara të noteri do të kërkohe vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, sipas konkursit në fjalë.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar për këtë pozitë.

Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e shpalljes në një nga mjetet e shkruara elektronike.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Sektorit të Personelit në QKUK (objekti i ri i administratës). Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Kontaktet me telefon mund t'i bëni në 038/512-667

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë të ofrojnë dëshmi sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Çdo kandidatë që aplikon dhe i plotëson kushtet sipas konkursit do t'i nënshtrohet testit më shkrim prej 100 poenëve. Kandidatët të cilët kalojnë 50 % të testit, fitojnë të drejtën të thirrjen për intervistim me gojë.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Spektori i Personelit



Prema članu 8 Zakona, tačka 1 i 2 Zakon o radu br. 03/L-212; Administrativno Uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru; Člana 6. tačka 1 i 1, član 10 tačka 1, član 13 tačka 1 i 3 Statuta Bolničke Službe i Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK); Član 62, Zakona br. 04/L-125, o Zdravstvo; Član 10 tačka 1.1.6, član 13, tačka 1, Statuta Universitetski Klinicki Centar Kosova; Član 5, tačka 1 i 2, Uredbe o Radnim Odnosima br. 1003 datum 21.07.2016; i Odluka br. 181/5 od dana 19.03.2019, Universitetski Klinicki Centar Kosova, objavljuje

KONKURS

Institucija:	Univerzitetski Klinicki Centar Kosova
Sektor:	Sektor za Održavanje Medicinske Opreme - UKCK,
Radna stopa:	Puni raspored,
Ugovor:	P
Naziv posla:	Viši Službenik za Održavanje Medicinske Opreme (1 pozicija)
Raportuje kod:	Šef Sektora za Održavanje Medicinskih Opreme,
Funkcionalna kategorija / Grad	8.4.
Br. Referenca:	UKCK - 12/2019-03/1

Viši službenik za medicinskih opreme:

Pod rukovodstvom Sektora za održavanje opreme, viši službenik za Održavanje medicinske opreme pomaže Direktor Klinikë i Upravi UKCK-a u svim pitanjima medicinske opreme potrebne za rad.

Glavne odgovornosti:

- Savetuje Direktore Klinikë UKCK da definišu neophodnu opremu za rad, -a u određivanju prioriteta potrebne opreme za rad,
- Obavestite Sektor održavanja opreme o uputstvima i uslovima održavanja opreme,
- Sastavlja tehničke specifikacije za medicinske uređaje koji su predviđeni za nabavku,
- Beleži medicinske uređaje u svim radnim jedinicama UKCK.
- Završetak tehničke dokumentacije opreme,

i principu rada,

- Održavanje periodične obuke u cilju profesionalizacije tehničara za održavanje medicinske opreme u okviru UKCK / UBKSK;
- Obavlja dodatne dužnosti na zahtev rukovodioca sektora. Fakulteti i inxhinierishtë mekanike ose elektronike

Potrebna kvalifikacija i iskustvo:

- Mašinski Fakultet ili Elektronski inxhinier,
- Odgovarajuće obrazovanje u oblasti medicinske opreme,
- Radno iskustvo u oblasti medicinske opreme najmanje 3 godina,
- Kompjuterski veštine u oblasti Kompjuterske opreme,
- Vještina organizacije i komunikacije u pisanom i govornom obliku,
- Znanje engleskog jezika.
- Izvod rođenja,
- Lična karta, fotokopija.

Dokumentacija priložena ovoj aplikaciji se ne vraća.

Original ovih dokumenata ili atestiranih notara će biti potreban samo kada se kandidat pozove na posao.

Uslovi učesća u zapošljavanju: Pravo prijave su svi državljani Republike Kosova odraslih koji imaju potpunu poslovnu sposobnost, u skladu sa konkursu u pitanju.

Procedura konkurencije: Konkurs je otvoren za sve kandidate zainteresirane za ovu poziciju.

Konkurs se objavljuje 15 dana od dana objavljivanja na jednom od elektronskih sredstava.

Podnošenje zahteva: Zahtev se primaju i dostavljaju u kancelariju UKCK - Kadrovske službe (Novog administrativnog objekta UKCK).

Aplikacija treba jasno navesti naziv posla i referentni broj. Telefonski kontakti se mogu izvršiti na 038/512-667

Zahtevi koje su poslate nakon završetka konkursa i nepotpune zahteve neće biti prihvaćene.

Podnosioci zahteva pruži dokaze od strane konkursa za različite kandidate koji ne ispunjavaju uslove konkursa neće biti pozvan na razgovor.

Svaki kandidat koji se prijavljuje i ispunjava uslove konkursa podleže pismenom testu od 100 bodova. Kandidati koji polože 50% testa, stiču pravo da budu pozvani na usmeni razgovor.

Generalnog Direktora UBKSK

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komna e Prizrenit

Opstina Prizren – Prizren Beledijesi

**DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
PRIZREN**

Numer:795/19

Datë: 26 mars 2019

Në bazë të Ligjit të Punës, nr.03/L-212, neni 8 paragrafi 1 dhe 2, neni 10 nënparagrafi 2.1 dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ nr 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren shpallë këtë:

**KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS
NË KOHË TË PACAKTUAR**

1. SHFMU “Mati Llogorec” ne Prizren, nje (1) punëtor teknik
2. SHFMU “Abdyl Frasheri” ne Prizren, dy (2) punëtor teknik
3. SHMU “Leke Dugagjini” ne Prizren. Dy (2) punëtor teknik
4. SHFMU “Pjeter Mazreku” ne Mazrek nje (1) punëtor teknik
5. SHFMU “Dy Deshmoret” ne Pirane nje (1) punëtor teknik
6. SHML “Gjon Buzuku” në Prizren nje punëtor teknik (1)

Kontrata e punës: në kohë të pacaktuar

Orari i plotë: 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë e punëtorit teknik

- ❖ Kujdeset për nivelin e pastërtisë së hapësirës shkollore
- ❖ Bënë pastrimin e dysHEMEVE, DYERVE, DRITAREVE, MUREVE, NYEJVE SANITARE, KORRIDOREVE ETJ.
- ❖ Pastrimi i rregullt i oborrit të shkollës dhe mirëmbajtja e gjelbërimit në hapësirën shkollore
- ❖ Njofton për të gjitha dëmet dhe defektet eventuale në shkollë
- ❖ Kujdeset për ruajtjen e objektit dhe inventarit të shkollës
- ❖ Kryen punë të tjera sipas kërkesës së drejtorisë së shkollës.

Kualifikimi: Përgatitja e mesme shkollore.

Çdo kandidat (aplikues) duhet të kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (fotokopje te vertetuar) si vijon:

1. Dëshmi mbi përgatitjen profesionale-kualifikimin, fotokopje e vërtetuar
2. Dokumentin e identifikimit - kopje e letërnjoftimit,
3. Certifikata që nuk është nën hetime dhe se nuk është i dënuar për vepra penale.
5. Certifikata mbi gjendjen shëndetësore.

Aplikacionet dorëzohen në Drejtorin Komunale per Arsim ne Prizren

Afati i aplikimit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes në web-faqen e komunës dhe mjetet e informimit publik. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Sqarim: Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet do të ftohen për test me shkrim dhe në intervistë. Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% e me shume të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë.

Drejtori
Skender Susuri



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për Tatimpagues

Mbjaj dokumentacionin sipas Ligjit!

Administrata Tatimore e Kosovës, ri-kujton të gjitha veprimtaritë ekonomike se janë të obliguara të mbajnë librat dhe regjistrimet konform legjislacionit tatimor.

Veprimtaritë ekonomike, të cilat krijojnë dhe mbajnë dokumentacione jo në rregull, si: shitje pa destinim-personave fizikë, blerjet nga personat fizikë, mos-dokumentimi dhe dokumentimi fiktiv, malli pa prejardhje-origjinë, fryrja e shpenzimeve, lëshimi i kuponëve fiskal nga distributorët, nënvlerësimi i çmimeve nga importi, mos-lëshimi i kuponëve fiskal, mbajtja e stoqeve dhe saktësia e tyre, dokumentimet tjera jo-reale, kreditimi dhe humbja e vazhdueshme, do të jenë në fokusin e ATK-së, derisa të arrihen objektivat për krijimin e një klimë të volitshme për të gjitha bizneset.

ATK-ja vlerëson se numri i tatimpaguesve, të cilët krijojnë dhe mbajnë dokumentacionin jo në rregull është i konsiderueshëm, i cili shkakton efekte negative në aktivitetet biznesore, krijon klimë jo konkurruese dhe jo lojale për vet operimin e biznesit dhe njëkohësisht krijon humbje për buxhetin e Kosovës.

Në identifikimin e rasteve të tilla, ATK-ja, në bazë të kompetencave është e autorizuar që të ndërmarrë veprimet e nevojshme me qëllim të verifikimit të librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesve dhe përcaktimit të drejtë të detyrimeve tatimore.

Vetëm tatimpaguesit, të cilët vullnetarisht mbajnë dhe prezantojnë librat dhe regjistrimet në harmoni me legjislacionin tatimor, nuk do të bëhen objekt ndëshkimi nga ana e ATK-së.

Tatimpaguesit të cilët nuk kanë përmbushur vullnetarisht detyrimin e tyre - mbajtjen dhe prezantimin e librave dhe regjistrimeve, i ftojme që vullnetarisht të bëjnë korrigjimet e nevojshme për të reflektuar gjendje reale mbi afarizmin e tyre, sepse në këtë mënyrë Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ju ofron lehtësira për tatimin shtesë të/pa deklaruar me kohë.

Synimi ynë i vetëm është ngritja e përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore, andaj ju inkurajojmë që të përmbushni detyrimet tuaja tatimore, në mënyrë që të mos bëheni objekt i ndëshkimeve.

Administrata Tatimore e Kosovës



Rishpallje publike

“Shprehje interesi / Ftesë publike”, në linkun zyrtar të webfaqes interne të Telekomit të Kosovës, në linkun vijues: <http://www.kosovotelecom.com/>

Me qëllim të organizimit të shpalljes publike për kompanitë e interesuara për bashkëpunim, si dhe përcaktimin e kriterëve për këtë veprimtari të shites së borxheve të këqija, Telekomit të Kosovës, iu bën ftesë publike kompanive të interesuara që të shprehin interesin e tyre për blerjen e borxheve të këqija ndaj Telekomit të Kosovës Sh.A.

Telekomit të Kosovës synon që përmes një procesi transparent t’ju ofrojë kushte të barabarta të ofertimit kompanive të specializuara dhe të interesuara ndërlidhur me blerjen e borxheve ndaj TK-së.

Në funksion të realizimit të këtij bashkëpunimi, Telekomit të Kosovës fton kompanitë e specializuara, të ofrojnë dhe propozojnë modelet në blerjen e borxheve të këqija (me të vjetra se një vit) duke përfshirë procedurat, aktivitetet karakteristike të bashkëpunimit deri në lidhjen e një marrëveshje të mundshme. Ky është një proces i hapur dhe fillon një ditë pas publikimit të këtij njoftimi dhe vijon me lidhjen e marrëveshjeve të veçanta.

Për të qenë pjesë e këtij partneriteti, fillimisht operatorët ekonomik/palët duhet:

- Të jenë kompani të cilat ofrojnë veprimtari në fushën e shëbimeve financiare, përkatësisht në fushën e grumbullit të borxheve dhe blerjen e borxheve të këqija, apo të ngajshme nga fusha e borxheve të këqija. Dëshmi mund të përdoret Certifikata e Regjistrimit të Biznesit dhe Informatave të biznesit. Kompanitë mund të jenë vendore dhe ndërkombëtare, kompanitë ndërkombëtare duhet të jenë të regjistruara në Republikën e Kosovës.
- Të kenë qarkullim vjetor në 3 vitet e fundit fiskale (total të deklaruar) afërsisht ose mbi 5 milion Euro ose dhe të ketë së paku 5 marrëveshje të natyrës së ngajshme të realizuara me kompani të ndryshme. Kjo kërkesë mund të plotësohet nga Operatori Ekonomik vetëm apo në konzorcium. Si dëshmi mund të përdoren Gjendja e tatimpaguesit e lëshuar nga autoriteti tatimor, ose Raporti i Pasqyrave Financiare të audituara.
- Të dorëzojnë historikun e kompanisë, propozimet e veta, lidhur me idetë që kanë për bashkëpunim në veprimtarinë e blerjes së borxheve të këqija.

Të gjitha kërkesat tuaja për të qenë pjesë e këtij partneriteti, së bashku me dëshmitë e kriterëve për palët e interesuara, ju lutemi t’i dërgoni përmes postës elektronike në email adresën vijuese: bdebt@kosovotelecom.com

Afati i fundit për dorëzimin e shprehjes së interesit është 7 ditë nga dita e shpalljes publike.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
Prishtinë

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

Sokol Koca ka humbur certifikatën e regjistrimit të biznesit DPT "MIGENA" me numër të biznesit: 80478534. Pronar i secilës është vet Sokol Koca me ID:1003950766, pasi që ky dokument me duhet për të vazhduar me aktivitet afarist të njëjtin e shpall të pavlefshme.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "ATLAS-N" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb. 70979969 dhe nr. fis. 601001358.

► Elfiqe Shaqiri shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme gjimnazi "Hamëz Jashari" Skenderaj.

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistrallja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Tel. 044-413-197, wiber: 045-198-095.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.]

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1906

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1906
0.5L